



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT
TË PËRGJITHSHËM DIBËR

**RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË
PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË
SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023**

MARS 2024

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

PËRMBAJTJA E RAPORTIT VJETOR TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR

I. STRUKTURA ORGANIZATIVE E PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR DHE PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË MAT, GJATË VITIT 2022 DHE VITIT 2023, SI REZULTAT I ZBATIMIT TË HARTËS SË RE GJYQËSORE.

II. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT NË VITIN 2023.

- Të dhëna dhe shpjegime për realizimin e objektivave prioritare të prokurorisë;
- Rritja e rolit aktiv të prokurorit, në filimin/regjistrimin e procedimeve kryesisht dhe kryerjen e hetimeve proaktive;
- Mbi zbatimin e Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm;
- Mbi zbatimin e Planit të Veprimit lidhur me rekomandimet në Rezolutën e Kuvendit;
- Mbi zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm të nxjerra në bazë të rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave dhe si kanë ndikuar në gjendjen e kriminalitetit në fushat e rekomanduara;
- Respektimi i të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtesave në procesin penal;
- Të miturit në konflikt me ligjin, viktima dhe dëshmitarë;
- Grupet vulnerabël të pandehur dhe viktima;
- Bashkëpunimin ndërinstitucional dhe zbatimin e akteve/marrëveshjeve me Prokurorinë e Posaçme, me MFE e MB, me KLSH, me ILDKPKI, BSH etj.;
- Bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja dhe/ose nëpërmjet prokurorit ndërlidhës shqiptar në EUROJUST;
- Të dhënat për temat dhe numrin e trajnimeve të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore apo të përbashkëta me Policinë e Shtetit për forcimin e kapaciteteve profesionale të tyre.

III. ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE PUNËS SË PROKURORISË.

- Volumi i punës në hetim (përfshihen: procedimet e mbartura; procedimet e reja të regjistruara për veprat penale të parashikuara në Kodin Penal dhe Kodin Penal Ushtarak; procedimet e rifilluara, si dhe vendimet e mosfillimit);
- Çështje të përfaqësuara në gjykatë;
- Treguesit kryesor të punës së prokurorisë (të dhëna statistikore për vendime mosfillimi, procedime pushuar, pezulluar, transferuar, dërguar për gjykim dhe të pandehur/persona nën hetim lidhur me to);
- Të dhëna në lidhje me njoftimet për veprat penale, ku të trajtohet si tregues të dhënat për njoftimet/raportimet e qytetarëve për korrupsion;
- Të dhëna në lidhje me masat e sigurimit personal sipas llojit dhe afatet e kohëzgjatjes së tyre, si dhe numri i personave me masë sigurimi arrest në burg/shtëpi ndaj të cilëve është vendosur pushimi i çështjes/akuzës;

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

- Të dhëna në lidhje me masat e sigurimit pasuror sipas llojit, ku për sekuestrimet të trajtohen llojet dhe vlera e pasurive të sekuestruara e krahasuar me vitin paraardhës;
- Treguesit e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, ku për konfiskimin e pasurive sipas llojeve (konfiskime në procesin penal dhe në procesin/hetimin pasuror sipas ligjit nr.10192, të vitit 2009) të trajtohet vlera e pasurive të konfiskuara të krahasuara me vitin paraardhës;
- Kriminaliteti sipas shtrirjes territoriale të njësive administrative në kompetencë të prokurorisë;
- Kriminaliteti sipas peshës/përhapjes së veprave penale dhe tendencave të tyre;
- Kriminaliteti sipas strukturës së Kodit Penal (krime – kundërvajtje).

IV. TREGUESIT STATISTIKORË 2 VJEÇAR TË VEPRAVE PENALE SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL.

- Të dhëna të krahasuara dhe shpjegime lidhur me numrin e procedimeve të regjistruara, numrin e procedimeve të dërguara për gjykim, numrin e të pandehurve dhe personave nën hetim të regjistruar, numrin e të pandehurve dërguar për gjykim, numrin e të pandehurve dënuar dhe urdhëruar ekzekutimi i tyre, si dhe tregues të tjerë.

V. ANALIZA E TREGUESVE TË EFEKTIVITETIT TË PUNËS SË PROKURORISË.

- Treguesi i efektivitetit në hetimin dhe ndjekjen penale, raporti i çështjeve dhe të pandehurve të dërguara me kërkesë për gjykim me ato të pushuara dhe raporti i çështjeve të pezulluara me çështjet e përfunduara në hetimet paraprake;
- Treguesi i efektivitetit në gjykimin dhe në dënimin e të pandehurve;
- Të dhëna për gjykimet e posaçme (numri i procedimeve për të cilat është proceduar me secilin nga llojet e gjykimeve të posaçme, numrin e të pandehurve lidhur me to, vendimarrja e gjykatës);
- Të dhëna mbi llojet dhe masat e dënimeve (kërkesat e prokurorit dhe disponimet e gjykatës);
- Të dhëna sociale dhe demografike si për të pandehurit, ashtu dhe për viktimat e veprave penale, si *gjinia, mosha, arsimi, punësimi*, etj;
- Të dhëna për të pandehurit e mitur si: numrin e procedimeve të regjistruara, numrin e procedimeve të dërguara për gjykim, numrin e të pandehurve dhe personave nën hetim të mitur të regjistruar, numrin e të pandehurve të mitur dërguar për gjykim, numrin e të pandehurve dënuar; numër procedimesh regjistruar, masa sigurimi e dënime të zbatuara, dënime alternative, etj;
- Të dhëna për pasojat e veprave penale.

VI. TË DHËNA LIDHUR ME MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA.

- Ekstradime (ekstradime nga jashtë, ekstradime për jashtë);
- Letërporositë (letërporositë nga jashtë, komisione rogatore dhe dorëzime të kontrolluara, letërporositë për jashtë);

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

- Njohjet e vendimeve penale (njohjet e vendimeve penale të huaja, njohjet e vendimeve penale shqiptare jashtë vendit);
- Transferime te procedimeve penale (transferimet e procedimeve nga jashtë, transferimet e procedimeve për jashtë);
- Transferime të personave të dënuar (transferimet e personave të dënuar nga jashtë, transferimet e personave të dënuar për jashtë);
- Shpalljet në kërkim ndërkombëtar, heqjet nga kërkimi ndërkombëtar.

VII. TË DHËNA PËR NGARKESËN DHE TREGUESIT E PUNËS PËR PROKURORËT, SHEFAT E SEKTORIT, ZËVENDËSPROKURORI DHE DREJTUESI I PROKURORISË.

- Të dhëna për ngarkesën e punës për officer të policisë gjyqësore të seksionit, zbatimi i sistemit elektronik përkatës dhe të oficerëve të shërbimeve të policisë gjyqësore në strukturat e policive apo agjencive ligjzbatuese përkatëse.

VIII. INFORMACION MBI ADMINISTRIMIN DHE VEPRIMTARINË ADMINISTRATIVE TË PROKURORISË.

- Zbatimi i buxhetit, marrëdhëniet me median dhe publikun, rregullsia e mbajtjes së regjistrave dhe raporteve, mbi zbatimin e CAMS, kapacitetet infrastrukturore dhe siguria, respektimi i disiplinës në punë dhe etikës nga punonjësit.

IX. INFORMACION PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE MEDIAT.

X. OBJEKTIVAT SIPAS DREJTIMEVE PRIORITARE NË VEPRIMTARINË ADMINISTRATIVE DHE FUNKSIONALE TË PROKURORISË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2024 DHE REKOMANDIME.

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

I. STRUKTURA ORGANIZATIVE E PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR DHE PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË MAT, GJATË VITIT 2022 DHE VITIT 2023, SI REZULTAT I ZBATIMIT TË HARTËS SË RE GJYQËSORE.

1. Në Prokurorinë pranë Gjykatës Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, sipas urdhërit nr.54, datë 18.04.2023, dërguar me shkresën nr.600/4 prot., datë 24.04.2023, të Prokurorisë së Përgjithshme, me të cilën është miratuar struktura organike e Prokurorisë pranë Gjykatës Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, duke përfshirë edhe organikën e ish-Prokurorisë pranë Gjykatës Shkallës së Parë Mat është si vijon:

1.1 Numri i prokurorëve dhe administrata gjatë vitit 2023.

1.1.1 Në vitin 2023, në Prokurorinë pranë Gjykatës Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, së bashku me ish-Prokurorinë pranë Gjykatës Shkallës së Parë Mat, numri i përgjithshëm i miratuar është **8 prokurorë**. Nga ky numër i përgjithshëm i miratuar i prokurorëve, ka patur dinamikë në këtë numër, pasi ky numër nuk ka qenë i plotë gjatë gjithë periudhës të vitit 2023.

1.1.2 Nga 8 prokurorë të miratuar, dinamika paraqitet si më poshtë:

1.1.2.1 4 (katër) prokurorë me kohë të plotë, efektiviteti 10 – 12 muaj = 4 prokurorë.

1.1.2.2 1 (një) prokuror i ka mbaruar statusi i magjistratit më datë 31.07.2023, efektiviteti 7 – 9 muaj = 0.75 %.

1.1.2.3 1 (një) prokuror është transferuar më datë 30.09.2023, efektiviteti 7 – 9 muaj = 0.75 %.

1.1.2.4 1 (një) prokuror ka marrë raport mjekësor lindje më datë 06.09.2023, efektiviteti 7 – 9 muaj = 0.75 %.

1.1.2.5 1 (një) prokuror është emëruar më datë 10.07.2023, efektiviteti 4 – 6 muaj = 0.5 %.

1.1.2.6 Në këto rrethana, me kohë të plotë kanë ushtruar veprimtarinë e tyre në detyrën e prokurorit 4 prokurorë.

1.1.3 Numri i miratuar i Oficerëve të Policisë Gjyqësore është 7, ndërsa numri faktik është 6.

1.2 Numri i përgjithshëm i administratës.

1.2.1 Kryesekretare 1 (një).

1.2.2 Kryetar Dege Buxhet Finance 1 (një).

1.2.3 Specialist – Arkivist 1 (një).

1.2.4 Sekretare 1 (një).

1.2.5 Koordinatorë 1 (një).

1.2.6 Ftuese 1 (një).

1.2.7 Shofer 1 (një).

1.2.8 Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme 1 (një).

1.2.9 Punonjës shërbimi 1 (një).

1.2.10 Sanitare (me kohë të pjesshme) 1 (një).

1.2.11 Arshiviste (me kohë të pjesshme) 1 (një).

1.2.12 Specialist IT 1 (vjë) - vakant.

1.2.13 Sekretar pranë prokurorit 1 (një) - vakant.

1.3 Numri faktik i prokurorëve për vitin **2023**, në Prokurorinë pranë Gjykatës Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka qenë:

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

Prokuroria Dibër	Prokurorë			Oficerë të Policisë Gjyqësore		Administrata		Gjithsej	
	Organika	Gjendja	Efektivë	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja
	8	6	6.75	7	6	12	9	27	22

1.4 Numri i prokurorëve dhe administrata gjatë vitit 2022.

1.4.1 Në vitin 2022, në Prokurorinë pranë Gjykatës Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, së bashku me ish-Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat, numri i përgjithshëm i miratuar është **9 prokurorë** (6 prokurorë Dibra dhe 3 prokurorë Mati). Nga ky numër i përgjithshëm i miratuar i prokurorëve, ka patur dinamikë në këtë numër, pasi ky numër nuk ka qenë i plotë gjatë gjithë periudhës së vitit 2022.

1.4.2 Nga 9 prokurorë të miratuar, dinamika paraqitet si më poshtë:

1.4.2.1 5 (pesë) prokurorë me kohë të plotë, efektiviteti 10 – 12 muaj = 5 prokurorë.

1.4.2.2 2 (dy) prokurorë janë emëruar më datë 27.07.2022, efektiviteti 4 – 6 muaj = 0.5 %.

1.4.2.3 1 (një) prokuror i Prokurorisë pranë Gjykatës Shkallës së Parë Dibër është shkarkuar nga detyra me vendimin nr.20, datë 31.01.2022, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), efektiviteti 0 %.

1.4.3 Në këto rrethana, me kohë të plotë, kanë ushtruar veprimtarinë e tyre në detyrën e prokurorit 5 prokurorë.

1.4.4 Numri i miratuar i Oficerëve të Policisë Gjyqësore gjatë vitit 2022 ka qenë 5 Dibra dhe 2 Mati, ndërsa numri faktik ka qenë 4.

1.5 Numri i përgjithshëm i administratës.

Kryesekretar/e dhe specialist financë: 2 (dy), 1 Dibra dhe 1 Mati.

Sekretarë: 4 (katër): 3 Dibra dhe 1 Mati.

Koordinatorë: 2 (dy), 1 Dibra dhe 1 Mati.

Ftuese: 1 (një) - Dibra.

Shofer: 2 (dy), 1 Dibra dhe 1 Mati.

Sanitare (me kohë të pjesshme): 1 (një).

Arshiviste (me kohë të pjesshme): 1 (një) - Dibra.

1.6 Numri faktik i prokurorëve për vitin **2022**, në Prokurorinë pranë Gjykatës Shkallës së Parë Dibër dhe në Prokurorinë pranë Gjykatës Shkallës së Parë Mat ka qenë:

Prokuroria Dibër dhe Prokuroria Mat	Prokurorë			Oficerë të Policisë Gjyqësore		Administrata		Gjithsej	
	Organika	Gjendja	Efektivë	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja	Organika	Gjendja
	6+3=9	7	5	5+2=7	5	13	12	29	24

II. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT NË VITIN 2023.

2.1 Të dhëna dhe shpjegime për realizimin e objektivave prioritare të prokurorisë:

2.1.1 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, si organ i ndjekjes penale, analizon në këtë raport veprimtarinë e punës të periudhës një-vjeçare,

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

për vitin 2023, gjendjen e kriminalitetit në territorin ku ushtron juridiksionin dhe veprimtarinë e saj, përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe kushtetuese, si institucion dhe prokurorëve që e përfaqësojnë atë, arritjet, problemet dhe mangësitë e evidentuara, realizimin e objektivave të vendosur për vitin 2023, si dhe përcaktimin e prioriteteve dhe drejtimeve kryesore për rritjen e performancës në veprimtarinë e saj në të ardhmen.

2.1.2 Gjatë vitit 2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka ushtruar veprimtarinë e saj në mbështetje dhe respektim të plotë të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, si dhe ato që burojnë nga marrëveshjet ndërkombëtare dypalëshe dhe shumëpalëshe, të ratifikuara me ligj nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Ushtrimi i kësaj veprimtarie kushtetuese dhe ligjore, ashtu siç edhe do të analizohet në vijim të këtij raporti, është kryer bazuar në një angazhim maksimal të të gjithë stafit të kësaj prokurorie, duke ndjekur dhe respektuar njëkohësisht urdhërat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë.

2.1.3 Në fokus të veprimtarisë të punës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka qenë lufta dhe ndëshkimi i krimeve kundër autoritetit të shtetit dhe kriminimit të organizuar, si fenomene të përhapura që kanë qenë dhe janë pengesë në zhvillimin e vendit dhe të shoqërisë në përgjithësi.

2.2 Rritja e rolit aktiv të prokurorit, në fillimin/regjistrimin e procedimeve kryesisht dhe kryerjen e hetimeve proaktive.

2.2.1 Prokurorët në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, gjatë periudhës vitit 2023, kanë rritur rolin aktiv në hetimin paraprak, sidomos në kryerjen e hetimeve proaktive dhe metodave speciale të hetimit.

2.2.2 Në kuadrin e këtij rekomandimi, Drejtuesi i Prokurorisë ka miratuar urdhërin nr.52, datë 03.10.2023 “Për miratimin e plan-veprimtimit në zbatim Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë” dhe në kuadër të zbatimit të rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023, ka nxjerrë udhëzimin nr.52/1, datë 03.10.2023 “Për Rekomandimet Prioritare në Luftën Kundër Kriminalitetit për vitin 2023, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër”, në të cilin janë normuar masa për rritjen e rolit aktiv të prokurorit në hetimet paraprake sipas ligjit, në funksion të shtimit të rasteve të hetimeve të filluara kryesisht për veprat penale prioritare të rekomanduara dhe kryerjen e hetimeve proaktive efektive me përdorimin e mjeteve të posaçme të hetimit për rritjen e mëtejshme të efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit për veprat penale prioritare, duke garantuar proces të rregullt ligjor, barazinë e shtetasve para ligjit dhe parimet e proporcionalitetit, ligjshmërisë, objektivitetit në procesin penal dhe paanshmërinë e prokurorëve në ushtrimin e funksioneve kushtetuese ligjore.

2.2.3 Gjatë vitit 2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka filluar një procedim penal për veprë penale prioritare kryesisht: konkretisht procedimi penal nr.528, datë 20.12.2023, për veprat penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 Kodit Penal dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/3 të Kodit Penal, me 3 autorë të arrestuar.

2.2.4 Nuk ka patur raste të tjera të fillimit kryesisht për vepra penale prioritare nga prokurorët.

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

2.2.5 Nuk ka patur raste të inicimit nga drejtuesi i prokurorisë për fillimin kryesisht të hetimeve proaktive për grupveprat penale prioritare të rekomanduara.

2.2.6 Për zbatimin e këtij rekomandimi, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka marrë masa administrative, duke rritur rolin aktiv të prokurorit në kontrollin e oficerëve të policisë gjyqësore, për zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme (nr.5/2018, nr.3/2019, nr.10/2020, nr.17/2020, nr.9/2021 dhe nr.2/2023) dhe akteve të tjera ligjore e normative, me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies, për të rritur eficientë dhe efikasitetin në ushtrimin e funksionit të tyre.

2.2.7 Nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore është raportuar mbi treguesit e zbatimit të këtyre udhëzimeve të përgjithshme dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore dhe mbikëqyrjes së veprimtarisë tyre. Gjatë kësaj periudhe, nuk janë evidentuar raste të shkeljeve disiplinore për të cilat është kërkuar fillimi i hetimit disiplinor.

2.2.8 Sistemi elektronik (SVHOPGJP) është vënë në punë dhe përmirësuar, si dhe funksionon për oficerët e policisë gjyqësore për monitorimin periodik të ngarkesës dhe disiplinës në punë gjatë veprimtarisë tyre, në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr.10, të vitit 2021, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkëpunimin me institucionet kushtetuese dhe ligjore”.

2.2.9 Në kuadër të marrjes masave për zbatimin e Rekomandimit II të parashikuar në Plan-Veprimin datë 06.07.2023, miratuar me urdhërin nr.103, datë 25.07.2023, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për marrjen e masave për mbrojtjen e viktimave të veprave penale të dhunës në familje dhe veprave penale ndaj të miturve”, gjatë periudhës së 9-mujorit të vitit 2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka rritur bashkëpunimin me institucionet shtetërore që ngarkohen me përgjegjësi në këtë drejtim sipas legjisllacionit në fuqi, i cili përkon me rekomandimin prioritar 7, drejtimi IV, i vendimit të Këshillit të Ministrave, “Rritjen e kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe veçanërisht të oficerëve të policisë gjyqësore, nëpërmjet trajnimeve veçanërisht për veprat penale me bazë gjinore, seksuale dhe përfshirjen e të miturve”, janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultate.

2.2.10 Në lidhje me masat efektive për mbrojtjen e viktimave të veprave penale të Dhunës në familje dhe veprave të tjera penale ndaj të miturve në vitin 2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka regjistruar 31 procedime penale për veprën penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, me 24 persona nën hetim, autorë të arrestuar, nga të cilët 13 persona janë me masë sigurimi personal me karakter shtërngues “Arresti në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, 2 persona me masë mjekësore, 6 persona me masë sigurimi personal me karakter shtërngues “Arresti në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale dhe 1 person me masë sigurimi personal me karakter shtërngues “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale. Nuk janë evidentuar raste të krimeve kundër fëmijëve në internet.

2.2.11 Si shkak i veprave penale të “Dhunës në familje”, janë evidentuar 33 viktima të dhunës në familje, prej të cilëve 4 meshkuj dhe 29 femra (1 e mitur). Nga këto 57 femra plagosur lehtë, 10 femra me pasojë rrahje dhe 4 meshkuj plagosur lehtë, ndërsa rastet e tjera dhunë psikologjike, ekonomike etj.

2.2.12 Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022, ku janë evidentuar (regjistruar) 54 procedime për veprën penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal,

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

me 57 autorë, prej të cilëve 30 të arrestuar. Siç shikohet, ka një rënie të numrit të veprave penale të kësaj kategorie me 28 vepra penale më pak për 9-mujorin e vitit 2023 se periudhën e 9-mujorit të vitit 2022.

2.2.13 Nuk kemi patur asnjë procedim penal të regjistruar për vepra penale me motive diskriminuese.

2.2.14 Nuk janë evidentuar vepra penale ndaj të miturve gjatë vitit 2023. Me urdhërin nr.43, datë 11.09.2023, për hetimin e grupveprave penale me të mitur në konflikt me ligjin, është caktuar prokurori Drini Zeqo dhe oficerja e policisë gjyqësore Erisa Skara.

2.2.15 Është rritur bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore që ngarkohen me përgjegjësi në këtë drejtim. Gjatë kësaj periudhe, nuk janë evidentuar vepra penale për krime të kryera kundër fëmijëve në internet.

2.2.16 Në lidhje me efektivitetin e hetimeve financiare, duhet bërë më shumë. Këto hetime duan trajnim të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.

2.2.17 Gjatë vitit 2023, nuk janë evidentuar raste të veprës penale “Falsifikimi i monedhave”, parashikuar nga neni 183 i Kodit Penal.

2.2.18 Janë ndjekur metodikat dhe protokollat e hetimit për vepra ose grup veprash penale që vlerësohen të nevojshme, ndaj dhe prokurorët e kësaj prokurorie kanë marrë pjesë në trajnimet e zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës gjatë vitit 2023, lidhur me këto tema.

2.2.19 Për sa i përket trajnimit të oficerëve të policisë gjyqësore, në të ardhmen është një domosdoshmëri e madhe për të rritur aftësimin profesional të tyre, me qëllim rritjen profesionale të tyre dhe të cilësisë së hetimit të çështjeve penale, sidomos atyre të pastrimit të parave, krimeve financiare, hetimet pasurore, çështjet me të mitur dhe me viktimat e dhunës së veprave penale të ndryshme.

2.2.20 Lidhur me rritjen e shkëmbimit të informacionit ndërmjet institucioneve të përfshira (agjencitë ligjzbatuese) për rastet e trafikimit të armëve të zjarrit, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, në funksion të zbatimit të ligjit penal, në mënyrë të vazhdueshme dhe sipas rastit, janë bërë analiza ndërinstitucionale për raste dhe çështje të veçanta në bashkëpunim të ngushtë me institucione të tjera. Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional midis policisë dhe prokurorisë, si dhe me institucionet e tjera ligjzbatuese brenda dhe jashtë vendit është evident. U është dhënë rëndësi dhe janë vlerësuar informacionet e ardhura nga institucione të tjera ligjzbatuese. Gjatë kësaj periudhe nuk është evidentuar ndonjë rast i trafikimit të armëve të zjarrit në juridiksionin që mbulojmë.

2.2.21 Gjatë periudhës së vitit 2023, në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit, si dhe në bashkëpunim me Shërbimin Informativ Shtetëror (SHISH), janë shkëmbyer informacione, si dhe janë referuar në prokurori materiale hetimore në fushën kryesisht të narkotikëve, të shpërdorimit të detyrës, ndërsa lidhur me rastet e trafikimit të armëve të zjarrit nuk ka patur informacione.

2.3 Mbi zbatimin e Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm.

2.3.1 Në zbatim të Rekomandimeve Prioritare të Këshillit Ministrave, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr.226, datë 13.04.2023, të prezantuar në mbledhjen e përbashkët datë 27.04.2023 me Ministrin e Drejtësisë, udhëzimit nr.2, datë 12.05.2023, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm” dhe urdhërit nr.70, datë 12.05.2023, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

“Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023””, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka marrë këto masa:

2.3.1.1 Masat administrative:

2.3.1.1.1 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër është njohur me “Rekomandimet Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023”, si dhe udhëzimin nr.2, datë 12.05.2023, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm” dhe urdhërin nr.70, datë 12.05.2023, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e “Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023””.

2.3.1.1.2 Në kuadrin e këtij rekomandimi, Drejtuesi i Prokurorisë ka miratuar urdhërin nr.52, datë 03.10.2023 “Për miratimin e Plan-Veprimit në zbatim Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, në kuadër të zbatimit të rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023, udhëzimi nr.52/1, datë 03.10.2023 “Për Rekomandimet Prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër”, në të cilin janë normuar masa për rritjen e rolit aktiv të prokurorit në hetimet paraprake sipas ligjit, në funksion të shtimit të rasteve të hetimeve të filluara kryesisht për veprat penale prioritare të rekomanduara dhe kryerjen e hetimeve proaktive efektive me përdorimin e mjeteve të posaçme të hetimit, për rritjen e mëtejshme të efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit për veprat penale prioritare, duke garantuar proces të rregullt ligjor, barazinë e shtetasve para ligjit dhe parimet e propocionalitetit, ligjshmërisë, objektivitetit në procesin penal dhe paanshmërinë e prokurorëve në ushtrimin e funksioneve kushtetuese ligjore.

2.3.1.2 Masat e marra në drejtim të riorganizimit të brendshëm të Hartës së Re Gjyqësore:

2.3.1.2.1 Në zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm nr.1, datë 26.01.2023 të Prokurorit të Përgjithshëm, nxjerrë në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr.495, datë 21.07.2022 “Për organizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka marrë të gjitha masat administrative dhe proceduriale për zbatimin e Hartës së Re Gjyqësore.

2.3.1.2.2 Në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimit, që ka të bëjë me implementimin e Hartës së Re Gjyqësore, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, ka nxjerrë urdhërin nr.18, datë 04.05.2023 “Për ngritjen e grupit të punës për identifikimin, marrjen në dorëzim dhe administrimin e akteve, provave materiale, objekteve ndërtimore/ambienteve, bazës materiale dhe automjeteve të ish-Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Mat”. Në këtë prokurori janë bërë rakordimet me regjistrat përkatës, dokumente, akte, kallëzime/referime, fashikuj të procedimeve penale dhe çështjet penale, procedimet pasurore, të krijuara dhe/ose të ardhura në këtë prokurori deri më datë 30.04.2023, të cilat janë mbartur më datë 01.05.2023, pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Gjatë mbartjes së këtyre materialeve/akteve proceduriale nuk janë hasur problematika.

2.3.1.2.3 Në zbatim të udhëzimit janë marrë të gjitha masat administrative dhe proceduriale duke ndjekur të gjitha:

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

2.3.1.2.3.a Kallëzimet penale/ose referimet e veprave penale të regjistruara në regjistrin përkatës që kanë qenë në fazën e verifikimit.

2.3.1.2.3.b Kallëzimet penale/ose referimet e veprave penale të regjistruara në regjistrin përkatës që kanë qenë në fazën e hetimeve paraprake.

2.3.1.2.3.c Procedimet penale të regjistruara në fazën e hetimeve paraprake pa disponim me vendim gjykate në këtë fazë.

2.3.1.2.3.d Procedimet e regjistruara, me persona nën hetim ose me të pandehur me masë sigurimi personal apo masë sigurimi pasuror apo me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit/me sigurim prove apo veprime të tjera, në këtë fazë, të disponuara me vendime gjyqësore.

2.3.1.2.3.e Çështjet në fazën e gjykimit, fashikujt me kërkesat e prokurorit të dërguara në gjykatë.

2.3.1.2.3.f Çështjet e ndryshme në fazë gjykimi themeli.

2.3.1.2.3.i Çështjet në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale.

2.3.1.2.3.j Vendimet e formës prerë të paekzekutuara.

2.3.1.2.3.g Procedimet/hetimet pasurore.

2.3.1.2.3.h Kërkesat e ardhura nga autoritet gjyqësore të huaja në fushën penale.

2.3.1.2.4 Lidhur me ecurinë e procesit të Hartës së Re Gjyqësore, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër nuk ka patur pasoja në respektimin e garancive procedurale të subjekteve të procedimit penal dhe sa i përket masave të sigurimit me arrest apo afateve të hetimit.

2.3.1.2.5 Të gjitha aktet, çështjet dhe procedimet, gjatë periudhës së mbartjes nga ish-Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës Parë Mat te Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, janë trajtuar me vëmendje, duke garantuar liritë dhe të drejtat e personave me masë sigurimi personal me karakter shtërngues “Arresti në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale apo me masë sigurimi personal me karakter shtërngues “Arresti në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, personave nën hetim, të pandehurve, viktimave.

2.3.1.2.6 Ndikim në implemetimin e Hartës së Re Gjyqësore pati lidhur me lëshimin e vërtetimeve për shtetasit banorë të Bashkisë Mat, për shkak të largësisë. Ky problem u zgjidh që shtetasit e Bashkisë Mat të mos paraqiten në organin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, por të paraqiten pranë sportelit në ish-godinën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat, ku atje ushtron funksionin një punonjëse/nëpunëse civile, e cila mban të dhënat dhe i përcjell nëpërmjet email-it në kryesekretarinë e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, ku pas verifikimeve përkatëse, plotësohen vërtetimet dhe i dërgohen punonjëses, që është edhe arkiviste në godinën e ish-Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat, e cila ua shpërndan vërtetimet qytetarëve.

2.3.1.2.7 Lidhur riorganizimin e Hartës së Re Gjyqësore, nuk ka patur ndikim në punën e prokurorisë, përveç problemeve teknike në fillim apo për shkak të përceptimit si një proces me të cilin një individ merr, përzgjedh dhe interpreton situatën për të formuar një kuptim koherent për gjithçka që e rrethon. I gjithë stafi ka marrë përgjegjësinë për menaxhimin e ndryshimit gjatë këtij procesi (riorganizimit të Hartës së Re Gjyqësore).

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

2.3.1.2.8 Janë ndjekur dhe zbatuar të gjitha pikat e rekomanduara në udhëzimit e përgjithshëm nr.1, datë 26.01.2023, të Prokurorit të Përgjithshëm, nxjerrë në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr.495, datë 21.07.2022 “Për organizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”.

2.3.1.2.9 I gjithë stafi i administratës ka qenë i orientuar në drejtim të menaxhimit të problemeve që mund të dilnin gjatë këtij procesi, duke ndihmuar prokurorët në punën e tyre për të qenë sa më eficient. Megjithëse çdo ndryshim perceptohet nga çdo individ në pikëpamje të ndryshme, procesi i zbatimit të Hartës së Re Gjyqësore nuk ka patur probleme në juridiksionin që mbulon Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

2.3.1.2.10 Lidhur me problematikat dhe nevojat e logjistikës, duhet theksuar se ambientet e godinës ku ushtrojmë veprimtarinë tonë nuk janë të përshtatshme, por së shpejti do të përfundojë godina e re që po ndërtohet/shtesa e katit në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, kjo falë punës së bërë nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme. Nevoja për logjistikë është e domosdoshme, është në dinamikë, pasi rrit eficientë në punën e prokurorisë. Për më tepër, për këtë problem, mund t'i paraqesim veçmas këtij informacioni. Jemi të mendimit se me mbarimin e godinës re/shtesës së katit, edhe këto probleme do të zgjidhen.

2.3.1.3 Masat proceduriale:

2.3.1.3.1 Lidhur me këtë masë Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka vlerësuar rekomandimet prioritare dhe nevojat për marrjen e masave proceduriale në kryerjen e hetimeve dhe ushtrimit e ndjekjes penale.

2.3.1.3.1.i Në funksion të zbatimit të kësaj mase, janë nxjerrë udhëzime nga Drejtuesi i Prokurorisë, si dhe janë zbatuar kërkesat e udhëzimit nr.2, datë 12.05.2023 “Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm” dhe urdhërit nr.70, datë 12.05.2023 “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e “Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023””, të nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm.

2.3.1.3.1.ii Gjatë vitit 2023, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë nuk është nxjerrë asnjë udhëzim jo i detyrueshëm për çështje konkrete sipas fazave të procedimit, përfshirë rastet e regjistruara/filluara kryesisht ose në rastet e hetimeve paraprake apo në gjykim, për veprat penale sipas kompetencës lëndore, si dhe për veprat penale që lidhen me korrupsionin, trafikimin e narkotikëve, pastrimin e parave, trafikimin e qenieve njerzore, krimet seksuale, dhunën në familje etj.

2.3.1.3.1.ii.1 Duke qenë se është e pamundur, për shkak të numrit të kufizuar të organikës me prokurorë, nuk janë krijuar seksione për kategori të caktuara veprash penale, duke u bazuar në nenin 21 të ligjit nr.97, të vitit 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

2.3.1.3.1.ii.2 Për hetimin e grupveprave penale me të mitur në konflikt me ligjin, me urdhërin nr.43, datë 11.09.2023, është caktuar prokurori Drini Zeqo dhe oficerja e policisë gjyqësore Erisa Skara.

2.3.1.3.1.ii.3 Për hetimin e grupveprave penale të pastrimit të produktit të veprës penale/financimit të terrorizimit/krimeve financiare/hetimeve pasurore, me urdhërin nr.44,

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

datë 11.09.2023, është caktuar prokurorja Alisa Spahja dhe oficeri i policisë gjyqësore Artan Ballabani.

2.3.1.3.1.iii Gjatë periudhës së vitit 2023 nuk ka patur raste të koordinimit të veprimtarisë me prokuroritë e tjera për çështje konkrete që lidhen me fushat/drejtimet prioritare.

2.3.1.3.1.iv Për vitin 2023 nuk ka patur kërkesa për informacion të bëra nga Drejtuesi i Prokurorisë lidhur me ecurinë e procedimeve.

2.3.1.3.1.v Në vitin 2023, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, janë regjistruar 921 materiale kallëzuese, nëpërmjet Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Çështjes (CAMS). Mënyra e ndarjes së çështjeve tek prokurorët kryhet sipas kësaj radhe: (i.) Materiali kallëzues, pasi bëhet hyrje në sekretari, i vendoset numri i protokollit, kalon tek drejtuesi dhe siglohet për short. (ii.) Hidhet në shortin elektronik (CAMS), regjistrohet në regjistrin e kallëzimeve dhe kundrejt nënshkrimit sipas prokurorit i jepet materiali kallëzues. (iii.) Më pas, nëse vendoset për regjistrimin e procedimit penal, regjistrohet në regjistrin e procedimeve të veprave penale, duke marrë numrin rendor progresiv. (iv.) Të dhënat pasqyrohen nëpër tabela elektronike “Microsoft Excel”. (v.) Shpërndarja e çështjeve jashtë shortit elektronik bëhet kur çështjet janë të regjistruara dhe lëvizin prokurorët (transferohen, lirohen ose dalin në pension). (vi.) Në këto rrethana, shpërndarja bëhet nëpërmjet shortit manual.

2.3.1.3.1.vi Gjatë gjithë vitit 2023, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore kanë koordinuar punën me zyrën e regjistrit, për pasqyrimin dhe ecurinë (dinamikën) e çështjeve në fazën e hetimit, seancave paraprake dhe të gjykimit, si dhe përditësimin e të dhënave. Janë dërguar të dhënat statistikore periodike dhe të tjera sipas kërkesës në Prokurorinë e Përgjithshme, sipas modelit të tabelave të dërguara.

2.3.1.3.1.vii Të dhëna për numrin e procedimeve penale sipas nenit 287 të Kodit Penal në ndjekje/gjendje, janë hedhur në sistemin PRESTO dhe numrin e procedimeve/hetimeve pasurore (sipas ligjit nr.10192, të vitit 2009), në ndjekje/gjendje për vitin 2023. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka në fazën e hetimeve paraprake 58 procedime penale për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal shqiptar, si dhe 34 hetime pasurore sipas ligjit nr.10192, të vitit 2009, ku subjekte janë persona, të cilët dyshohen të jenë të përfshirë në aktivitete të paligjshme jashtë dhe brenda vendit. Nga ana e ofierëve të policisë gjyqësore është raportuar në mënyrë sistematike mbi treguesit e zbatimit të këtyre udhëzimeve të përgjithshme dhe akteve të tjera, ligjore e nënligjore dhe mbikëqyrjes së veprimtarisë tyre.

2.3.1.3.1.vii.1 Gjatë kësaj periudhe nuk janë evidentuar raste të shkeljeve disiplinore për të cilat është kërkuar fillimi i hetimit disiplinor. Sistemi elektronik (SVHOPGJP) është në punë dhe është përmirësuar, si dhe funksionon për oficerët e policisë gjyqësore për monitorimin periodik të ngarkesës dhe disiplinës në punë gjatë veprimtarisë tyre në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr.10, të vitit 2021, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkëpunimin me institucionet kushtetuese dhe ligjore”.

2.3.1.4 Masat e marra nga Drejtuesi i Prokurorisë, në drejtim të numrit të procedimeve të filluara kryesisht, numrit të mbledhjeve tematike, numrit të kërkesave për verifikimin e ecurisë

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

apo përfundimin e çështjeve për veprat penale prioritare, numrit të urdhërave të nxjerrë për policinë gjyqësore etj.

2.3.1.4.i Lidhur me masat e marra në këto drejtime, Prokurororia pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, gjatë vitit 2023, ka filluar 1 procedim penal kryesisht, konkretisht procedimi penal nr.528, datë 20.12.2023, për veprat penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal, me 3- autorë të arrestuar. Nuk ka patur raste të inicimit nga Drejtuesi i Prokurorisë për fillimin kryesisht të hetimeve proaktive për grupveprat penale prioritare të rekomanduara.

2.3.1.4.ii Janë kryer hetime të shpejta dhe janë respektuar të drejtat dhe garancitë procedurale, si në drjetim të të miturve në konflikt me ligjin, të miturve dëshmitarë dhe viktimave të veprave penale. Për të gjitha rastet, pyetja e të miturve është bërë në prani të avokatit dhe psikologut. Gjithashtu, për veprat penale prioritare janë respektuar të drejtat dhe garancitë procedurale, që kanë të bëjnë me aftatet e hetimeve paraprake dhe afatet e paraburgimit, duke respektuar të drejtat e subjekteve procedurale.

2.3.1.4.iii Drejtuesi i Prokurorisë, në mënyrë të vazhdueshme, ka kërkuar dhe verifikuar informacionin për ecurinë e çështjeve dhe përfundimin e tyre, kryesisht për çështjet prioritare sipas rekomandimeve, ato të pastrimit të parave dhe produkteve të saj dhe të kultivimit të bimëve narkotike, duke marrë masat e duhura për regjistrimin dhe administrimin e të dhënave të nevojshme, që i shërbejnë hetimit. Janë respektuar me përpikmëri afatet procedurale, si dhe janë respektuar të drejtat e subjekteve të procedimit.

2.3.1.4.iii.1 Në këtë kuadër e në mënyrë të vazhdueshme janë zhvilluar takime dhe mbledhje me drejtues të policisë, të organeve të tjera ligjzbatuese dhe oficerët e policisë gjyqësore, për ndjekjen dhe hetimin e çështjeve të regjistruara për veprat prioritare të rekomanduara, si ato të pastrimit të parave dhe produkteve të saj, evazionit fiskal, krimin financiar, korrupsionit, kultivimit të bimëve narkotike, duke bërë një analizë të përbashkët të thelluar të fakteve.

2.3.1.4.iv Çdo muaj, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë janë zhvilluar dhe zhvillohen mbledhjet periodike me oficerët e policisë gjyqësore dhe stafin mbi problematikat, njohjen me urdhërat dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe prioritare në këto mbledhje ka qenë ecuria e hetimit, efikasiteti dhe problematikat e ndeshura në hetim, duke i analizuar çështjet që janë në hetim. Ky efikasitet duket edhe në numrin relativisht të lartë të çështjeve të përfunduara, duke parë dhe problematikat që dalin.

2.3.1.4.v Në mënyrë të vazhdueshme bëhet monitorimi i të dhënave në sistemin elektronik “Statistika e veprimeve hetimore të oficerëve të policisë gjyqësore në prokurori” (SVHOPGJP), për numrin e veprimeve hetimore të kryera.

2.3.1.4.vi Janë marrë të gjitha masat për garantimin e paanshmërisë dhe shmangien e çdo influence ose ndikimi ndaj prokurorit gjatë kryerjes së hetimit dhe ushtrimit të detyrës.

2.3.1.4.vi.1 Në të gjithë veprimtarinë e punës së prokurorëve, është bërë mbështetja brenda mundësive me burime njerëzore dhe logjistike. Duhet theksuar se aktualisht nuk ka ambiente të duhura dhe me standarde për akomodimin e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore. Nuk ka ambiente të përshtatshme në prokurori në zbatim të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, për të siguruar akses për persona me aftësi të kufizuar dhe pritjen e publikut sipas prioriteteve të rekomanduara.

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

2.3.1.4.vii Gjatë veprimtarisë hetimore, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka koordinuar punën me prokuroritë e tjera në fusha të ndryshme, si dhe në rastet e veprave penale prioritare.

2.3.1.4.viii Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër janë marrë masa për rritjen e bashkëpunimit me Policinë e Shtetit dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese në funksion të hetimit të specializuar, të shpejtë dhe të gjithanshëm, në goditjen e grupeve kriminale me rrezikshmeri të lartë shoqërore, kryesisht të grupeve kriminale të trafikimit të lëndëve narkotike, krimeve të rënda me ndikim të lartë shoqëror, krimin kundër korrupsionit dhe atij financiar, pasi janë kryer analiza të përbashkëta për procedime të veçanta me Policinë e Shtetit për këto grup veprash penale, që janë në rekomandimet prioritare, si ato të trafikimit të lëndëve narkotike, pastrimit të parave, korrupsionit etj.

2.3.1.4.viii.1 Në rritjen e rasteve të përfshirjes, në kryerjen e veprimeve të përbashkëta hetimore të oficerëve të shërbimeve të tjera të policive gjyqësore, për hetimin e veprave penale, sidomos në funksion të rritjes së efektivitetit të hetimeve ndaj subjekteve, që priren të kryejnë evazion fiskal apo nëpunësve publikë të administratës tatimore.

2.3.1.4.viii.2 Gjithashtu, është rritur bashkëpunimi ndërinstytucional ndërmjet drejtorive përkatëse të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Prokurorisë së Përgjithshme, me qëllim shkëmbimin në kohë reale të informacionit, përmirësimin e cilësisë dhe shpejtësisë së kryerjes së veprimeve procedurale, në kuadër të letërporosive nga autoritetet e huaja dhe të komunikimit të akteve, ku u janë kthyer përgjigje dhe dërguar informacion brenda afateve të gjitha kërkesave për ekstradim ardhur nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm apo nga Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme. Është koordinuar puna me institucione të tjera lidhur me të dhënat statistikore në fushën e veprave penale të pastrimit të parave etj.

2.3.1.4.ix Në zbatim të memorandumit të bashkëpunimit, udhëzimit të përgjithshëm nr.10, të vitit 2020 “Për rritjen më tej të veprimtarisë ndërinstytucionale”, si dhe në funksion të njohjes dhe zbatimit të legjislacionit penal dhe rritjen profesionale të prokurorëve, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër kanë qenë pjesë e programeve të trajnimit dhe seminareve të zhvilluara, përfshi ato për rritjen e kapaciteteve profesionale në luftën kundër pastrimit të parave dhe produkteve të veprimtarisë kriminale, krimin financiar dhe hetimeve pasurore, për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve/produkteve kriminale.

2.3.1.5 Masat procedurale të marra nga prokurorët lidhur me rekomandimet prioritare për luftën kundër kriminalitetit, duke krahasuar treguesit e vitit 2022 me ato të vitit 2023.

2.3.1.5.i Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, gjatë vitit 2023, ka filluar 1 procedim penal kryesisht, konkretisht procedimin penal nr.528, datë 20.12.2023, për veprat penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/3 i Kodit penal, me 3 autorë të arrestuar. Nuk ka patur raste të inicimit nga Drejtuesi i Prokurorisë për fillimin kryesisht të hetimeve proaktive për grupveprat penale prioritare të rekomanduara. Kjo, në krahasim me vitin 2022, ku nuk është filluar asnjë procedim penal kryesisht nga prokurorët.

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

2.3.1.5.ii Lidhur me të dhënat për numrin e procedimeve penale sipas nenit 287 të Kodit Penal në ndjekje/gjendje në sistemin PRESTO dhe numrin e procedimeve/hetimeve pasurore (sipas ligjit nr.10192, të vitit 2009), në ndjekje/gjendje më datë 30 shtator 2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka në fazën e hetimeve paraprake 58 procedime penale për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal shqiptar, si dhe 34 hetime pasurore sipas ligjit nr.10192, të vitit 2009, ku subjekte janë katër persona, të cilët dyshohen të jenë të përfshirë në aktivitete të paligjshme jashtë dhe brenda vendit.

2.3.1.5.ii.1 Me urdhërin nr.44, datë 11.09.2023, për hetimin e grupveprave penale të pastrimit të produktit të veprës penale/financimit të terrorizimit/krimeve financiare/hetimeve pasurore është caktuar prokurorja Alisa Spahja dhe oficeri policisë gjyqësore Artan Ballabani.

2.3.1.5.ii.2 Lidhur me të dhënat statistikore mbi hetimet paralele, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër nuk janë kryer hetime paralele në asnjë rast dhe nuk është ngritur akuzë për veprat penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizimit, janë kryer hetime pasurore e financiare të aseteve dhe produkteve të veprës penale, por nuk është kryer asnjë sekuestrim apo konfiskim i këtyre aseteve.

2.3.1.5.ii.3 Për periudhën e vitit 2023 janë regjistruar 7 hetime pasurore sipas ligjit nr.10192, të vitit 2009, në krahasim me vitin 2022, ku janë regjistruar 6 referime pasurore sipas ligjit nr.10192, të vitit 2009.

2.3.1.5.ii.4 Ndërsa, për veprën penale të “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, për periudhën e vitit 2023, nuk është regjistruar asnjë procedim penal.

2.3.1.5.iii Gjatë vitit 2023, nga ana e prokurorëve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, nuk ka patur asnjë rast marrëveshjeve të bashkëpunimit sipas nenit 37/a të Kodit të Procedurës Penale, për vënien para përgjegjësive të bashkëpunëtorëve në veprimtarinë kriminale dhe për të parandaluar apo riparuar dëmet e shkaktuara për veprat penale prioritare të rekomanduara.

2.3.1.5.iv Bazat e të dhënave për përdorimin me efikasitet për rritjen e efektivitetit të hetimeve për veprat penale prioritare të rekomanduara, janë sistemi TIMS i Policisë Shtetit, Platforma Qeveritare e Ndërveprimit e-Albania dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

2.3.1.5.v Në periudhën e vitit 2023, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër janë kryer në mënyrë periodike analiza të përbashkëta me oficerët e policisë gjyqësore të prokurorisë dhe shërbimeve të policisë.

2.3.1.5.v.1 Këto analiza kanë patur si fokus shkëmbimin e informacioneve lidhur me ecurinë e hetimeve, përmirësimin e hetimeve të specializuara ndaj subjekteve të veprave penale prioritare. Në këtë kuadër e në mënyrë të vazhdueshme janë zhvilluar takime dhe mbledhje me drejtues të policisë, të organeve të tjera ligjzbatuese dhe oficerët e policisë gjyqësore, për ndjekjen dhe hetimin e çështjeve të regjistruara për veprat prioritare të rekomanduara, si ato të pastrimit të parave dhe produkteve të saj, evazionit fiskal, krimi financiar, korrupsionit, kultivimit të bimëve narkotike, duke bërë një analizë të përbashkët të thelluar të fakteve.

2.3.1.5.vi Lidhur me masat e marra për ruajtjen e sekretit të hetimit dhe ndalimin e publikimit të akteve, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

Përgjithshëm Dibër ka ripunuar nenet 103 dhe 104 të Kodit Procedurës Penale dhe nenet 295, 295/a dhe 296 të Kodit Penal.

2.3.1.5.vii Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, zbatimi i Rezolutës së Kuvendit dhe i udhëzimeve të përgjithshme ka ndikuar në unifikimin e veprimtarisë administrative e funksionale dhe rritjen e performancës së prokurorisë. Gjithashtu, zbatimi i kërkesave të Rezolutës së Kuvendit, siç është analizuar për çdo zë në këtë informacion, ka ndikuar mbi uljen e gjendjes së kriminalitetit në juridiksionin që mbulon kjo prokurori, në zbulimin dhe rritjen e zbulueshmërinë e autorëve të kryerjes së veprave penale dhe në dënimin e tyre, si dhe masat e marra për trajtimin e viktimave të veprave penale, duke i orientuar dhe njohur me të drejtat e tyre gjatë procesit penal, konform udhëzimit nr.5, të vitit 2018 “Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale, mbi trajtimin e tyre”.

2.3.1.5.viii Janë kryer hetime të shpejta dhe janë respektuar të drejtat dhe garancitë procedurale, si në drejtim të të miturve në konflikt me ligjin, të miturve dëshmitarë dhe viktimave të veprave penale.

2.3.1.5.viii.1 Për të gjitha rastet, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, pyetja e të miturve në konflikt me ligjin është bërë në prani të avokatit dhe të psikologut, ku po kështu është vepruar dhe me të miturit dëshmitarë dhe viktimat e veprës penale, që kërkon detyrimisht praninë e psikologut/koordinatorit.

2.3.1.5.viii.2 Mbi aplikimin e dënimeve alternative në rastet e veprave penale dhe/ose autorëve me rrezikshmëri të ulët shoqërore, veçanërisht në rastet me të mitur, ky lloj dënimi është patur në konsideratë gjatë procesit të gjyqimit. Nga ana e prokurorit janë aplikuar nenet 55, 58 dhe 67 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe konkretisht masa e paralajmërimit me shkrim dhe shmangia nga dënimi.

2.3.1.5.ix Në rastet e veprave prioritare, prokurorët kanë ndjekur një politikë penale eficiente me qëllim rritjen e efikasitetit në luftën kundër kriminalitetit për krimet prioritare të rekomanduara, si dhe për parandalimin e posaçëm dhe të përgjithshëm të këtyre veprave.

2.3.1.6 Në lidhje me masat efektive për mbrojtjen e viktimave të veprave penale të dhunës në familje e veprave të tjera penale ndaj të miturve në vitin 2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka regjistruar 31 procedime penale për veprën penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, me 24 persona nën hetim, autorë të arrestuar, nga të cilët 13 persona janë me masë sigurimi personal me karakter shtërngues “Arresti në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, 2 persona me masë mjekësore, 6 persona me masë sigurimi personal me karakter shtërngues “Arresti në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale dhe 1 person me masë sigurimi personal me karakter shtërngues “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale. Nuk janë evidentuar raste të krimeve kundër fëmijëve në internet.

2.3.1.7 Si shkak i veprave penale të “Dhunës në familje”, janë evidentuar 33 viktima të dhunës në familje, prej të cilëve 4 meshkuj dhe 29 femra (1 e mitur). Nga këto 57 femra plagosur lehtë, 10 femra me pasojë rrahje dhe 4 meshkuj plagosur lehtë, ndërsa rastet e tjera dhunë psikologjike, ekonomike etj.

2.3.1.8 Në drejtim të rasteve të veprave penale të Kultivimit të bimëve narkotike, gjatë vitit 2023 janë regjistruar 18 raste për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

nga neni 284 i Kodit Penal, me 15 të pandehur, nga të cilët 9 të arrestuar me masë sigurimi personal me karakter shtërngues “Arresti në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

2.3.1.9 Janë dhënë 23 masa alternative për 23 të mitur në konflikt me ligjin, duke i shmangur nga dënimi, si dhe dënimi alternativ për persona vulnerabël, me rrezikshmëri të ulët shoqërore.

2.3.1.10 Në drejtim të trajnimeve, tryezave e diskutimeve, për zbatimin e dizpozitave të reja të Kodit Penal, janë zhvilluar takime midis seksioneve dhe shërbimeve të policisë gjyqësore, duke kryer trajnime të përbashkëta.

2.4 Mbi zbatimin e Planit të Veprimit lidhur me rekomandimet në Rezolutën e Kuvendit.

2.4.1 Në zbatim të Rekomandimeve Prioritare të Këshillit Ministrave, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr.226, datë 13.04.2023, të prezantuar në mbledhjen e përbashkët datë 27.04.2023 me Ministrin e Drejtësisë, udhëzimit nr.2, datë 12.05.2023, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm” dhe urdhërit nr.70, datë 12.05.2023, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e “Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023””, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka marrë këto masa:

2.4.2 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër është njohur me “Rekomandimet Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023”, si dhe udhëzimin nr.2, datë 12.05.2023, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për rekomandimet prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023 në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm” dhe urdhërin nr.70, datë 12.05.2023, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e “Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023””.

2.5 Garantimi i pavarësisë dhe përgjegjësisë së prokurorit.

2.5.1 Prokurorët në Prokurorinë Pranë Gjykatës Shkallës Parë me Juridiksion të Përgjithshëm Dibër, gjatë periudhës së vitit 2023 kanë rritur rolin aktiv në hetimin paraprak, sidomos në kryerjen e hetimeve proaktive dhe metodave speciale të hetimit.

2.5.2 Në kuadrin e këtij rekomandimi, Drejtuesi i Prokurorisë ka miratuar urdhërin nr.52, datë 03.10.2023 “Për miratimin e Plan-Veprimit në zbatim Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, në kuadër të zbatimit të rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023, udhëzimi nr.52/1, datë 03.10.2023 “Për Rekomandimet Prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër”, në të cilin janë normuar masa për rritjen e rolit aktiv të prokurorit në hetimet paraprake sipas ligjit, në funksion të shtimit të rasteve të hetimeve të filluara kryesisht për veprat penale prioritare të rekomanduara dhe kryerjen e hetimeve proaktive efektive me përdorimin e mjeteve të posaçme të hetimit, për rritjen e mëtejshme të efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit për veprat penale prioritare, duke garantuar proces të rregullt ligjor, barazinë e shtetasve para ligjit dhe parimet e propocionalitetit, ligjshmërisë, objektivitetit në procesin penal dhe paanshmërinë e prokurorëve në ushtrimin e funksioneve kushtetuese ligjore.

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

2.5.3 Gjatë vitit 2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka filluar një procedim penal për veprë penale prioritare kryesisht: konkretisht procedimi penal nr.528, datë 20.12.2023, për veprat penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 Kodit Penal dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/3 të Kodit Penal, me 3 autorë të arrestuar.

2.5.4 Nuk ka patur raste të tjera të fillimit kryesisht për vepra penale prioritare nga prokurorët.

2.5.5 Nuk ka patur raste të inicimit nga drejtuesi i prokurorisë për fillimin kryesisht të hetimeve proaktive për grupveprat penale prioritare të rekomanduara.

2.5.6 Për zbatimin e këtij rekomandimi, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka marrë masa administrative, duke rritur rolin aktiv të prokurorit në kontrollin e oficerëve të policisë gjyqësore, për zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme (nr.5/2018, nr.3/2019, nr.10/2020, nr.17/2020, nr.9/2021 dhe nr.2/2023) dhe akteve të tjera ligjore e normative, me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies, për të rritur efikasitetin dhe funksionin në ushtrimin e funksionit të tyre.

2.5.7 Nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore është raportuar mbi treguesit e zbatimit të këtyre udhëzimeve të përgjithshme dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore dhe mbikëqyrjes së veprimtarisë tyre. Gjatë kësaj periudhe, nuk janë evidentuar raste të shkeljeve disiplinore për të cilat është kërkuar fillimi i hetimit disiplinor.

2.5.8 Sistemi elektronik (SVHOPGJP) është vënë në punë dhe përmirësuar, si dhe funksionon për oficerët e policisë gjyqësore për monitorimin periodik të ngarkesës dhe disiplinës në punë gjatë veprimtarisë tyre, në zbatim të udhëzimit të përgjithshëm nr.10, të vitit 2021, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për ushtrimin e funksionit të monitorimit në sistemin e prokurorisë dhe bashkëpunimin me institucionet kushtetuese dhe ligjore”.

2.5.9 Në kuadër të marrjes masave për zbatimin e Rekomandimit II të parashikuar në Plan-Veprimin datë 06.07.2023, miratuar me urdhërin nr.103, datë 25.07.2023, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për marrjen e masave për mbrojtjen e viktimave të veprave penale të dhunës në familje dhe veprave penale ndaj të miturve”, gjatë periudhës së 9-mujorit të vitit 2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka rritur bashkëpunimin me institucionet shtetërore që ngarkohen me përgjegjësi në këtë drejtim sipas legjislacionit në fuqi, i cili përkon me rekomandimin prioritar 7, drejtimi IV, i vendimit të Këshillit të Ministrave, “Rritjen e kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe veçanërisht të oficerëve të policisë gjyqësore, nëpërmjet trajnimeve veçanërisht për veprat penale me bazë gjinore, seksuale dhe përfshirjen e të miturve”, janë zhvilluar aktivitetet dhe arritur rezultate.

2.5.10 Në lidhje me masat efektive për mbrojtjen e viktimave të veprave penale të Dhunës në familje dhe veprave të tjera penale ndaj të miturve në vitin 2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka regjistruar 31 procedime penale për veprën penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, me 24 persona nën hetim, autorë të arrestuar, nga të cilët 13 persona janë me masë sigurimi personal me karakter shtërngues “Arresti në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, 2 persona me masë mjekësore, 6 persona me masë sigurimi personal me karakter shtërngues “Arresti në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale dhe 1 person me masë sigurimi personal me karakter shtërngues “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

gjqësore”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale. Nuk janë evidentuar raste të krimeve kundër fëmijëve në internet.

2.5.11 Si shkak i veprave penale të “Dhunës në familje”, janë evidentuar 33 viktima të dhunës në familje, prej të cilëve 4 meshkuj dhe 29 femra (1 e mitur). Nga këto 57 femra plagosur lehtë, 10 femra me pasojë rrahje dhe 4 meshkuj plagosur lehtë, ndërsa rastet e tjera dhunë psikologjike, ekonomike etj.

2.5.12 Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022, ku janë evidentuar (regjistruar) 54 procedime për veprën penale “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, me 57 autorë, prej të cilëve 30 të arrestuar. Siç shikohet, ka një rënie të numrit të veprave penale të kësaj kategorie me 28 vepra penale më pak për 9-mujorin e vitit 2023 se periudhën e 9-mujorit të vitit 2022.

2.5.13 Nuk kemi patur asnjë procedim penal të regjistruar për vepra penale me motive diskriminuese.

2.5.14 Nuk janë evidentuar vepra penale ndaj të miturve gjatë vitit 2023.

2.5.15 Me urdhërin nr.43, datë 11.09.2023, për hetimin e grupveprave penale me të mitur në konflikt me ligjin, është caktuar prokurori Drini Zeqo dhe oficerja e policisë gjyqësore Erisa Skara.

2.5.16 Është rritur bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore që ngarkohen me përgjegjësi në këtë drejtim. Gjatë kësaj periudhe, nuk janë evidentuar vepra penale për krime të kryera kundër fëmijëve në internet.

2.5.17 Në lidhje me efektivitetin e hetimeve financiare, duhet bërë më shumë. Këto hetime duan trajnim të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.

2.5.18 Gjatë vitit 2023, nuk janë evidentuar raste të veprës penale “Falsifikimi i monedhave”, parashikuar nga neni 183 i Kodit Penal.

2.5.19 Janë ndjekur metodikat dhe protokollet e hetimit për vepra ose grup veprash penale që vlerësohen të nevojshme, ndaj dhe prokurorët e kësaj prokurorie kanë marrë pjesë në trajnimet e zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës gjatë vitit 2023, lidhur me këto tema.

2.5.20 Për sa i përket trajnimit të oficerëve të policisë gjyqësore, në të ardhmen është një domosdoshmëri e madhe për të rritur aftësimin profesional të tyre, me qëllim rritjen profesionale të tyre dhe të cilësisë së hetimit të çështjeve penale, sidomos atyre të pastrimit të parave, krimeve financiare, hetimet pasurore, çështjet me të mitur dhe me viktimat e dhunës së veprave penale të ndryshme.

2.5.21 Lidhur me rritjen e shkëmbimit të informacionit ndërmjet institucioneve të përfshira (agjencitë ligjzbatuese) për rastet e trafikimit të armëve të zjarrit, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, në funksion të zbatimit të ligjit penal, në mënyrë të vazhdueshme dhe sipas rastit, janë bërë analiza ndërinstytucionale për raste dhe çështje të veçanta në bashkëpunim të ngushtë me institucione të tjera. Forcimi i bashkëpunimit ndërinstytucional midis policisë dhe prokurorisë, si dhe me institucionet e tjera ligjzbatuese brenda dhe jashtë vendit është evident. U është dhënë rëndësi dhe janë vlerësuar informacionet e ardhura nga institucione të tjera ligjzbatuese. Gjatë kësaj periudhe nuk është evidentuar ndonjë rast i trafikimit të armëve të zjarrit në juridiksionin që mbulojmë.

2.5.22 Gjatë periudhës së vitit 2023, në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit, si dhe në bashkëpunim me Shërbimin Informativ Shtetëror (SHISH), janë shkëmbyer informacione, si dhe janë referuar në prokurori materiale hetimore në fushën kryesisht të narkotikëve, të

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

shpërdorimit të detyrës, ndërsa lidhur me rastet e trafikimit të armëve të zjarrit nuk ka patur informacione.

2.6 Lufta kundër korrupsionit.

2.6.1 Gjatë vitit 2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka filluar një procedim penal për veprë penale prioritare kryesisht: konkretisht procedimi penal nr.528, datë 20.12.2023, për veprat penale “Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 Kodit Penal dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/3 të Kodit Penal, me 3 autorë të arrestuar.

2.6.2 Është regjistruar 1 procedim penal për veprën penale “Korrupsioni në sektorin privat”, parashikuar nga neni 164/b i Kodit Penal.

2.6.3 Nuk ka patur raste të tjera të fillimit kryesisht për vepra penale prioritare nga prokurorët.

2.6.4 Nuk ka patur raste të inicimit nga drejtuesi i prokurorisë për fillimin kryesisht të hetimeve proaktive për grupveprat penale prioritare të rekomanduara.

2.6.5 Për zbatimin e këtij rekomandimi, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka marrë masa administrative, duke rritur rolin aktiv të prokurorit në kontrollin e oficerëve të policisë gjyqësore, për zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme (nr.5/2018, nr.3/2019, nr.10/2020, nr.17/2020, nr.9/2021 dhe nr.2/2023) dhe akteve të tjera ligjore e normative, me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies, për të rritur efikasitetin dhe efikasitetin në ushtrimin e funksionit të tyre.

2.7 Lufta kundër krimit të organizuar.

2.7.1 Të dhënat me treguesit/indiktorët që evidentojnë rritjen e rolit aktiv të prokurorit në hetimet paraprake, në funksion të rritjes së numrit të hetimeve proaktive dhe rritjes së numrit të hetimeve të filluara kryesisht nga prokuroria, si dhe rezultatet e arritura.

2.7.2 Në kuadër të këtij rekomandimi, vëmendje u është kushtuar hetimi i veprave penale në fushën e narkotikëve, ku janë përdorur mjetet e posaçme të hetimit, ku janë regjistruar 10 procedime penale për nenin “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, me 12 autorë të arrestuar, si dhe janë regjistruar 18 procedime penale për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal, me 9 autorë të arrestuar.

2.7.3 Prokurorët në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, në bashkëpunim me shërbimet e policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit dhe agjencitë e zbatimit të ligjit, sipas kërkesave dhe procedurave ligjore, në vitin 2023, kanë rritur rolin aktiv në kryerjen e hetime proaktive dhe/ose me përdorim të mjeteve të posaçme të hetimit, në kuadrin e 16 procedimeve penale. Prokurorët kanë patur rol aktiv, si në regjistrimin e procedimeve, dhënien e autorizimeve ose mbi kërkesën e tyre me vendime gjyqësore është autorizuar përdorimi i mjeteve të posaçme të hetimit, ashtu dhe nëpërmjet lënies së detyrave oficerëve të policisë gjyqësore dhe kontrollit/mbikëqyrjes për zbatimin e tyre.

2.7.4 Lidhur me të dhënat për numrin e procedimeve penale sipas nenit 287 të Kodit Penal në ndjekje/gjendje në sistemin PRESTO dhe numrin e procedimeve/hetimeve pasurore (sipas ligjit nr.10192, të vitit 2009), në ndjekje/gjendje më datë 30 shtator 2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka në fazën e hetimeve paraprake 58 procedime penale për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal shqiptar, si dhe 34 hetime pasurore sipas ligjit nr.10192, të vitit 2009, ku subjekte janë katër persona, të cilët dyshohen të jenë të përfshirë në aktivitete të paligjshme jashtë dhe brenda vendit.

2.7.5 Me urdhërin nr.44, datë 11.09.2023, për hetimin e grupveprave penale të pastrimit të produktit të veprës penale/financimit të terrorizimit/krimeve financiare/hetimeve pasurore është caktuar prokurorja Alisa Spahja dhe oficeri policisë gjyqësore Artan Ballabani.

2.7.6 Lidhur me të dhënat statistike mbi hetimet paralele, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër nuk janë kryer hetime paralele në asnjë rast dhe nuk është ngritur akuzë për veprat penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, janë kryer hetime pasurore e financiare të aseteve dhe produkteve të veprës penale, por nuk është kryer asnjë sekuestrim apo konfiskim i këtyre aseteve.

2.7.7 Për periudhën e vitit 2023 janë regjistruar 7 hetime pasurore sipas ligjit nr.10192, të vitit 2009, në krahasim me vitin 2022, ku janë regjistruar 6 referime pasurore sipas ligjit nr.10192, të vitit 2009.

2.8 Respektimi i të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve në procedimin penal.

2.8.1 Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër është zbatuar me përpikmëri kuadri ligjor për forcimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Për sa i përket rasteve të zbatimit të instrumenteve të reja penale, siç është urdhëri penal, gjykimi me marrëveshje apo rritja e numrit të rasteve të gjykimit të drejtëpërdrejtë, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, për vitin 2023 nuk janë zbatuar këto instrumente, por është aplikuar gjykimi i drejtëpërdrejtë në 19 raste. Si rezultat i aplikimit të gjykimit të drejtëpërdrejtë është përmirësuar efikasiteti në hetimin dhe është ulur norma e kohëzgjatjes mesatare të hetimit të çështjeve. Ndërsa, lidhur me zbatimin e institucionit të gjykimit me marrëveshje, nuk është aplikuar në asnjë rast për këtë vit.

2.8.2 Janë kryer hetime të shpejta dhe janë respektuar të drejtat dhe garancitë procedurale si në drejtim të të miturve në konflikt me ligjin, të mitur dëshmitarë dhe viktimat të veprave penale.

2.8.3 Për të gjitha rastet nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, pyetja e të miturve në konflikt me ligjin është bërë në prani të avokatit dhe të psikologut gjithashtu, ku po kështu është vepruar dhe me të mitur dëshmitarë dhe viktimat të veprës penale, që kërkon detyrimisht praninë e psikologut/koordinatorit.

2.8.4 Mbi aplikimin e dënimeve alternative në rastet e veprave penale dhe/ose autorëve me rrezikshmëri të ulët shoqërore, veçanërisht në rastet me të mitur, ky lloj dënimi është patur në konsideratë gjatë procesit të gjykimit dhe gjykata. Nga ana e prokurorit janë aplikuar nenet 55, 58 dhe 67 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur e konkretisht masa e paralajmërimit me shkrim dhe shmangia nga dënimi është aplikuar për 27 raste me pushim çështje (shmangie), duke zbatuar për 18 raste llojin e masës “Paralejmërim me shkrim”, për 5 raste masën “Paralejmërim me gojë” dhe për 4 raste shkaqe të tjera.

2.8.5 Nuk ka pasur asnjë procedim penal të regjistruar për veprat me natyrë gjinore, seksuale dhe diskriminuese apo të keqtrajtimit/abuzimit/shfrytëzimit e trafikimit të fëmijëve.

2.8.6 Janë përmirësuar dukshëm aftësitë profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve të ngarkuar me hetimin e çështjeve, që lidhen me drejtësinë penale për të mitur,

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

duke i këshilluar për kryerjen e veprimeve, duke u vënë në dispozicion për njohjen dhe zbatimin me përpikmëri të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, hyrë në fuqi më datë 01.01.2018 dhe ligjit nr.37, të vitit 2017, si dhe të strategjisë së drejtësisë dhe planit të veprimit për vitin 2022 për këtë kategori.

2.9 Të miturit në konflikt me ligjin, viktima dhe dëshmitarët. Grupet vulnerabël të pandehur dhe viktima.

2.9.1 Qëllimi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër përgjatë vitit 2023, në zbatim të ligjit nr.37, të vitit 2017, datë 30.03.2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” ka qenë promovimi dhe mbrojtja efektive e të drejtave për të miturit në konflikt me ligjin, viktima, dëshmitarë të veprave penale dhe të miturit që nuk kanë mbushur moshën për përgjegjësi penale.

2.9.2 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, gjatë vitit 2023, ka regjistruar gjithsej 31 procedime penale me 32 të pandehur/persona nën hetim, 32 nga të cilët të mitur (meshkuj), 9 të grup moshës 14-16 vjeç dhe 23 të grup moshës 16-18 vjeç.

2.9.3 Në përfundim rezulton se:

2.9.3.1 Për 31 procedime penale me 27 të mitur në konflikt me ligjin është vendosur pushimi i çështjes në bazë të nenit 55, 56, 58 dhe 67 të ligjit nr.37, të vitit 2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit”, si edhe nenit 328, gërma “f”, të Kodit të Procedurës Penale, për shkak se ndaj të miturit në konflikt me ligjin është zbatuar masa e shmangies nga ndjekja penale.

2.9.3.2 Të miturit në konflikt me ligjin janë hetuar në gjendje të lirë. Prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër janë angazhuar në sesione trajnuese me qëllim rritjen profesionale, kryesisht në lidhje me ndryshimet që ka pësuar legjisllacioni penal procedural dhe material, si dhe në fushën e drejtësisë penale për të mitur.

2.9.3.3 Gjithashtu, në kuadër të vendimit nr.255, datë 19.12.2018, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, vlen të theksohet se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, në vazhdimësi është angazhuar në garantimin e përmbushjes së të drejtave për personat me aftësi të kufizuara viktimë apo person nën hetim, duke garantuar prezencën e mbrojtësit dhe të psikologut, zbatimin korrekt të masave të sigurimit për të pandehurit me probleme të shëndetit mendor, duke u angazhuar çdo një vit në verifikimin e kushteve të masave mjekësore të caktuara më herët.

2.10 Bashkëpunimi ndërinstytucional dhe zbatimi i akteve/marrëveshjeve me Prokurorinë e Posaçme, me MFE e MB, me KLSH, me ILDKPKI, BSH etj.

2.10.1 Numri më i madh i procedimeve penale të regjistruara ka ardhur nga referimi i strukturave të Policisë Shtetit. Kështu, nga 921 materiale kallëzuese në total të regjistruara për vitin 2023, 16 materiale kallëzuese janë bërë nga shtetaist, 9 materiale kallëzuese janë bërë nga nëpunësit publik, 3 materiale kallëzuese janë bërë nga shtetas për korrupsion dhe 893 materiale kallëzuese të referuara nga strukturat e Policisë së Shtetit, që përbëjnë peshën më të madhe të referimeve, e shprehur në përqindje në masën 97 %, e zënë nga referimet e kryera nga strukturat e Policisë së Shtetit.

2.10.2 Bashkëpunimi me këto institucione ka qenë shumë i ngushtë, për një qëllim të përbashkët, parandalimin e krimeve, evidentimin dhe dokumentimin e tyre, vënien e autorëve para përgjegjësisë penale dhe ndëshkimit të tyre sipas ligjit me qëllim, parandalimin e përgjithshëm dhe të posaçëm të veprave penale në të ardhmen.

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

2.10.3 Numri më i madh i procedimeve penale të regjistruara ka ardhur nga referimi i strukturave të Policisë së Shtetit.

2.10.4 Raporti me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Bashkëpunimi me Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka qenë korrekt dhe i bazuar me pavarësinë e secilit organ. Prokurorët kanë qenë korrekt në paraqitjen e tyre në seancat gjyqësore si për sa i përket etikës, ashtu edhe përfaqësimit të çështjeve. Nuk ka pasur raste të evidentuara nga ndonjë gjyqtar në lidhje me sjelljen, etikën, paraqitjen apo përfaqësimin e akuzës nga ana e prokurorëve në Gjykatë. Është koordinuar puna në rastet e trajnimit të përbashkët të prokurorëve dhe gjyqtarëve.

2.10.5 Raporti me Institucionet e tjera. Një bashkëpunim reciprok ka pasur edhe me institucionet e tjera lokale dhe qendrore, si me MFE, Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Zyrën Përmbarimore, Zyrën e Shërbimit të Provës, Insitucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Burrel etj., në nxjerrjen në kohë të urdhërave të ekzekutimit të vendimeve penale nga ana e prokurorit, në mbikëqyrjen në vazhdimësi të ekzekutimit dhe zbatimit të dënimeve penale, kohën e provës etj. Vetëm për vitin 2023 janë nxjerrë në zbatim të vendimeve gjyqësore 254 urdhëra ekzekutimi nga ana e prokurorit, lidhur me dënimet me burgim, me gjobë, dënimet alternative, provat materiale dhe shpenzimet procedurale.

2.10.6 Institucionet e tjera kanë qenë bashkëpunuese, janë kthyer në kohë përgjigjet e kërkesave të organit të prokurorisë në funksion të hetimit të procedimeve penale etj. Janë organizuar takime me faktorët e tjerë për sensibilizimin e opinionit për të dhënë ndihmën e duhur në parandalimin e veprave penale në marrëdhëniet familjare, në ndikimin pozitiv të grupeve vulnerabël, sidomos të të miturve për të mos kryer vepra penale, etj.

2.11 Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja dhe/ose nëpërmjet prokurorit ndërlidhës shqiptar në EUROJUST.

2.11.1 Bashkëpunimi me autoritetet gjyqësore ndërkombëtare është arritur nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme. Siç u theksua më sipër, prokurorët janë angazhuar në ekzekutimin e letër-kërkesave të ndryshme të autoriteteve të huaja gjyqësore, si në njoftimin e dëshmitarëve, njoftimin e të pandehurve, njoftimin e vendimeve penale të gjykatave të huaja etj.

2.12 Të dhënat për temat dhe numrin e trajnimeve të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore apo të përbashkëta me Policinë e Shtetit për forcimin e kapaciteteve profesionale të tyre.

2.12.1 Prokurorët e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër janë angazhuar në mënyrë të vazhdueshme në sesione trajnuese të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, Prokuroria e Përgjithshme apo faktorë të tjerë të angazhuar në trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, me qëllim rritjen profesionale të tyre.

2.12.2 Drejtuesi i Prokurorisë Abaz Muça rezultoi të ketë marrë pjesë në 20 trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës.

2.12.3 Prokurori Urim Buci rezultoi të ketë marrë pjesë në 5 trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës.

2.12.4 Prokurorja Xhoana Mehmetaj rezultoi të ketë marrë pjesë në 16 trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës.

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

2.12.5 Prokurorja Alisa Spahja rezulton të ketë marrë pjesë në 5 trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës.

2.12.6 Prokurori Urim Kalia rezulton të ketë marrë pjesë në 5 trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës.

2.12.7 Prokurori Drini Zeqo rezulton të ketë marrë pjesë në 5 trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës.

2.12.8 Oficerët e Policisë Gjyqësore Erisa Skara, Artan Ballabani, Azi Mustafallari, Amarildo Margjoni dhe Ilir Haxhiaj kanë kryer 5 trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës.

2.12.9 Oficeri i Policisë Gjyqësore Aldo Puca ka kryer 4 trajnime të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës.

III. ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE PUNËS SË PROKURORISË.

3.1 Volumi i punës në hetim¹.

3.1.1 Gjatë vitit 2023, në organin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër janë trajtuar **2335 materiale kallëzuese** që përbëjnë një rritje prej 9.7 % në krahasim me vitin 2022 ose **227 materiale kallëzuese** më shumë se në vitin 2022, në të cilin janë trajtuar **2108 materiale kallëzuese**.

3.1.2 Janë mbartur 811 procedime penale me një rritje prej 4.3 % ose 35 procedime penale më shumë, krahasuar me procedimet penale të vitit 2022, vit kur janë mbartur 776 procedime.

3.1.3 Janë regjistruar në Regjistrin e Veprave Penale gjithsej 574 procedime penale, prej të cilave 18 kanë ardhur me transferim dhe 6 prej tyre nga totali janë transferuar, me 212 persona nën hetim.

3.1.4 Nëse krahasojmë procedimet penale të regjistruara në vitin 2023 me ato të vitit 2022, ku janë regjistruar 711 procedime, me 254 persona në hetim, kemi me një ulje prej 19.3 % ose 137 procedime penale më pak.

3.1.5 Në vitin 2023 janë rifilluar 408 procedime penale, që tregon një rritje me 61.5 % ose 251 procedime më shumë, në krahasim me vitin 2022, ku janë rifilluar 177 procedime penale.

3.1.6 Nëse krahasojmë procedimet penale të regjistruara në vitin 2023, me ato të vitit 2022, ku janë regjistruar 711 procedime penale, kemi me një ulje prej 19.3 % ose 137 procedime penale më pak.


3.1.7 Është vendosur mosfillimi për 542 referime dhe materiale kallëzuese, prej të cilëve 372 referime/materiale kallëzuese që janë regjistruar në vitin 2023 dhe 170 materiale kallëzuese të tjera kanë qenë të mbartura. Në krahasim me vitin 2022, ku është vendosur “*Mosfillimi i procedimit penal*” për 301 materiale kallëzuese ose 71 kallëzime/materiale kallëzuese/19 % më shumë se në vitin 2022. Në këtë llogaritje janë marrë për bazë vetëm kallëzimet e regjistruara për vitin 2022 dhe 2023, jo të mbarturat.

3.1.8 Me Hartën e Re Gjyqësore, për vitin 2023 janë regjistruar gjithsej **574 procedime penale** në rang qarku, ku përfshihen 4 bashki, Bashkia Dibër, Bashkia Bulqizë, Bashkia Klos dhe Bashkia Mat. Ndërsa, në vitin 2022 janë regjistruar 711 procedime penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër dhe në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së


¹ Përfshihen: procedimet e mbartura; procedimet e reja të regjistruara për veprat penale të parashikuara në Kodin Penal dhe Kodin Penal Ushtarak; procedimet e rifilluara, si dhe vendimet e mosfillimit.

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

Parë Mat. Vërehet një ulje prej 19.3 % ose 137 procedime penale më pak se në vitin 2022, ku ushtronin veprimtarinë dy Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër dhe Mat.




3.1.9 Gjatë vitit 2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, nga procedimet në ndjekje, ka përfunduar gjithsej **1217 procedime penale**, nga të cilat për 296 procedime penale i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër me kërkesë me objekt “*Dërgimin e çështjes në gjyq*”, për 376 procedime penale ka konkluduar me vendim me objekt “*Pushimin e çështjes*” ose i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër me kërkesë me objekt “*Pushimin e çështjes*”, 133 procedime penale janë pezulluar, 408 procedime penale janë rifilluar nga të pezulluarat dhe të pushuara, si dhe 6 procedime penale janë transferuar, që përbën një rritje me 296 procedime më shumë ose 24 % në krahasim me vitin 2023, ku kanë përfunduar 921 procedime penale, nga të cilat për 311 procedime penale i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër me kërkesë me objekt “*Dërgimin e çështjes në gjyq*”, për 330 procedime penale ka konkluduar me vendim me objekt “*Pushimin e çështjes*” ose i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër me kërkesë me objekt “*Pushimin e çështjes*”, 100 procedime penale janë pezulluar, 157 procedime penale janë rifilluar dhe 6 procedime penale janë transferuar.




RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023


3.1.10 Janë ndjekur gjatë vitit 2023 gjithsej 1793 procedime penale, nga të cilat 811 të mbartura, 408 të rifilluara dhe 574 të regjistruara, që përbëjnë një rritje prej 7.5% ose 135 procedime penale më shumë në krahasim me vitin 2022, vit në të cilin janë ndjekur 1658 procedime penale, nga të cilat 776 të mbartura, 171 të rifilluara dhe 711 të regjistruara. Të dhënat paraqiten sipas grafikut si më poshtë:



3.1.11 Në vitin 2023, raporti i numrit të volumit në hetim me numrin organik, faktik dhe efektiv të prokurorëve, paraqitet 2335 materiale të trajtuara gjatë vitit 2023 ndaj 2123 materialeve të trajtuara gjatë vitit 2022, sipas grafikut si më poshtë:




3.1.12 Ngarkesa mesatare e volumit në hetim sipas numrit organik të prokurorëve paraqitet 292 çështje gjatë vitit 2023 ndaj 234 çështjeve gjatë vitit 2022, sipas grafikut si më poshtë:




RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023



3.1.13 Ngarkesa mesatare e volumit në hetim sipas numrit faktik të prokurorëve paraqitet 389 çështje gjatë vitit 2023 ndaj 301 çështjeve gjatë vitit 2022, sipas grafikut si më poshtë:



3.1.14 Ngarkesa mesatare e volumit në hetim sipas numrit efektiv të prokurorëve paraqitet 343 çështje gjatë vitit 2023 ndaj 421 çështjeve gjatë vitit 2022, sipas grafikut si më poshtë:



3.1.15 Të dhëna mbi procedimet e regjistruara dhe numrin e të pandehurëve të regjistruar gjatë vitit 2023, si dhe raporti i këtyre të dhënave me vitin 2022.



RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023


3.1.16 Procedime të regjistruara për çdo prokuror sipas numrit organik:



3.1.17 Procedime të regjistruara për çdo prokuror sipas numrit faktik:



3.1.18 Procedime të regjistruara për çdo prokuror sipas numrit efektiv:



3.1.19 Raporti i procedimeve të përfunduara me çështjet e regjistruara gjatë vitit 2023: Në vitin 2023 janë regjistruar 574 procedime penale dhe përfunduar 343 prej tyre, që zënë një përqindje prej 40.2%. Nga procedimet e regjistruara, për 151 i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër me kërkesë me objekt “*Dërgimin e çështjes në gjyq*” me 141 të pandehur, për 70 procedime penale i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër me kërkesë me objekt “*Pushimin e çështjes*”, për 59 procedime penale është konkluduar me vendim me objekt “*Pushimin e çështjes*”, janë pezulluar 61 procedime penale dhe janë transferuar 2 procedime penale.

3.2 Çështje të përfaqësuara në gjykatë.

3.2.1 Gjatë vitit 2023, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër është ngritur dhe përfaqësuar akuza në gjykatë, në emër të shtetit, duke përfshirë këtu edhe çështjet e mbartura në gjykim, për 330 çështje me 431 të pandehur, 35 prej të cilëve me masë sigurimi personal me karakter shtërngues “Arresti në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

Viti	Çështje të përfaqësuara në gjykatë përfunduara	Të pandehur	Të arrestuar
2023	249 Dibra + 13 Mati = 262	287 Dibra + 16 Mati = 303	25 Dibra + 10 Mati = 35

3.3 Treguesit kryesor të punës së prokurorisë (të dhëna statistikore për vendimet e mosfillimit, procedimet e pushuara, pezulluara, transferuara, dërguar për gjykim dhe të pandehur/persona nën hetim lidhur me to).

3.3.1 Për vitin 2023, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër është vendosur “*Mosfillimi i procedimit penal*” për 542 materiale kallëzuese, nga të cilat 372 materiale kallëzuese të regjistruara për vitin 2023 dhe 170 materiale kallëzuese të mbartuara.

3.3.2 Janë mbartur 811 procedime penale me një rritje prej 4.3 % ose 35 procedime penale më shumë, krahasuar me procedimet penale të vitit 2022, vit në të cilin janë mbartur 776 procedime penale.

3.3.3 Janë regjistruar në Regjistrin e Veprave Penale gjithsej 574 procedime penale, prej të cilave 18 procedime penale kanë ardhur me transferim dhe 6 procedime penale janë transferuar.

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

3.3.4 Nëse krahasojmë procedimet penale të regjistruara në vitin 2023, me ato të vitit 2022, ku janë regjistruar 711 procedime penale, kemi një ulje prej 19.3% ose 137 procedime penale më pak.

3.3.5 Me Hartën e Re Gjyqësore, për vitin 2023 janë regjistruar gjithsej 574 procedime penale në rang qarku, ku përfshihen 4 bashki, Bashkia Dibër, Bashkia Bulqizë, Bashkia Klos dhe Bashkia Mat. Ndërsa, në vitin 2022 janë regjistruar 711 procedime penale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër dhe në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat. Vërehet një ulje prej 19.3 % ose 137 procedime penale më pak se në vitin 2022, ku ushtronin veprimtarinë dy Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër dhe Mat.

3.3.6 Në vitin 2023 janë rifilluar 408 procedime penale, të cilat 406 procedime penale të pezulluara dhe 2 procedime penale të pushuara, që tregon një rritje me 61.5 % ose 251 procedime penale më shumë, në krahasim me vitin 2022, ku janë rifilluar 177 procedime penale.

3.3.7 Janë pushuar 376 procedime penale me 128 persona nën hetim, që tregon një rritje prej 46 procedimesh penale më shumë ose një rritje prej 12 %, krahasuar me vitin 2022, ku janë pushuar 330 procedime penale me 129 persona nën hetim.

3.3.8 Në të gjitha këto procedime penale janë kryer veprime hetimore të plota dhe në çdo rast është bërë njoftimi i vendimit të pushimit si kallëzuesit, institucioneve apo individëve dhe palëve të interesuara.

3.3.9 Nga 367 çështje penale të pushuara rezulton se në 279 raste prokurori ka proceduar më paraqitjen e kërkesës me objekt “*Pushimin e çështjes*” drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, në bazë të neneve 328/1 dhe 329/a të Kodit të Procedurës Penale, si dhe është vendosur “*Pushimi i çështjes*” për 97 raste kundërvajtje penale dhe në zbatim të nenit 328/1, gërma “f”, nenit 58 të Kodit Drejtësisë Penale për të Mitur (shmangie).

3.3.10 Janë pezulluar 133 procedime penale, janë transferuar 6 procedime penale dhe janë dërguar në gjyq 296 procedime penale, me 334 të pandehur, me 42 persona të arrestuar.

Mosfillime & Procedime	Numri i Mosfillimeve & Procedimeve	Persona nën hetim	Të pandehur	Të arrestuar
Mosfillime 2023	372			
Mosfillime të mbartura	170			
Të mbartura 2022	811	328	164	6
Të regjistruara 2023	556	211	169	67
Ardhur me transferim	18	1	8	1
Të transferuara	6			
Të pezulluara	133			
Të rifilluara të pezulluara	406			
Të rifilluara të pushuara	2			
Procedime të pushuara	376	128		
Totali	2850	668	341	74

3.3.11 Në lidhje me çështjet e dërguara përpara Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër me kërkesë me objekt “*Dërgimin e çështjes në gjyq*”, për vitin 2023 janë dërguar përpara Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër me kërkesë

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

me objekt “Dërgimin e çështjes në gjyq” 296 procedime penale, me 334 të pandehur dhe 42 të arrestuar ose 15 procedime më pak, që tregojnë një ulje prej 4.8 %, krahasuar me vitin 2022 ku janë dërguar 311 procedime penale përpara Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër me kërkesë me objekt “Dërgimin e çështjes në gjyq”, me 416 të pandehur dhe 71 persona me masë sigurimi personal.

VITI	Çështje të dërguara për gjykim	Të pandehur	Të arrestuar
2022	311	416	71
2023	296	334	42

3.4 Të dhëna në lidhje me njoftimet për veprat penale, ku trajtohet si tregues të dhënat për njoftimet/raportimet e qytetarëve për korrupsion.

3.4.1 Numri më i madh i procedimeve penale të regjistruara ka ardhur nga referimi i strukturave të Policisë së Shtetit. Kështu, nga 921 materiale kallëzuese në total të regjistruara për vitin 2023, 16 materiale kallëzuese janë bërë nga shtetaist, 9 materiale kallëzuese janë bërë nga nëpunësit publik, 3 materiale kallëzuese janë bërë nga shtetas për korrupsion dhe 893 materiale kallëzuese të referuara nga strukturat e Policisë së Shtetit, që përbëjnë peshën më të madhe të referimeve, e shprehur në përqindje në masën 97 %, e zënë nga referimet e kryera nga strukturat e Policisë së Shtetit.

3.5 Të dhëna në lidhje me masat e sigurimit personal sipas llojit dhe afatet e kohëzgjatjes së tyre, si dhe numri i personave me masë sigurimi arrest në burg/shtëpi ndaj të cilave është vendosur pushimi i akuzës/çështjes.

3.5.1 Nga personat nën hetim, mbi bazën e referimit të akteve paraprake, përgjatë vitit 2023, kanë ardhur me masë të përkohshme nga policia gjyqësore “Arrest në flagrancë” dhe “Ndalim” 153 persona të dyshuar për kryerjen e veprave të ndryshme penale ose 2 persona më pak të arrestuar/ndaluar krahasuar me vitin 2022.

3.5.2 Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër është kërkuar caktimi i masës së sigurimit personal me karakter shtërngues ndaj 165 personave, ku për 70 persona është kërkuar caktimi i masës së sigurimit personal me karakter shtërngues “Arresti në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, për 8 persona është kërkuar caktimi i masës së sigurimit personal me karakter shtërngues “Arresti në burg”, në mungesë, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale dhe për 1 person është kërkuar caktimi i masës së sigurimit personal me karakter shtërngues “Arresti në burg”, me afat, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, për 1 person është kërkuar caktimi i masës së sigurimit personal me karakter shtërngues “Shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik”, parashikuar nga neni 239 i Kodit të Procedurës Penale, për 31 persona është kërkuar caktimi i masës së sigurimit personal me karakter shtërngues “Arresti në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale dhe në 53 raste është kërkuar caktimi i masës së sigurimit personal me karakter shtërngues “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale.

3.5.2 Nga ana e Gjykatës, për 61 persona është vendosur caktimi i masës së sigurimit personal me karakter shtërngues “Arresti në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, për 8 persona është vendosur caktimi i masës së sigurimit personal me karakter shtërngues “Arresti në burg”, në mungesë, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, për 1 person është vendosur caktimi i masës së sigurimit personal me

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

karakter shtërngues “Arresti në burg”, me afat, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, për 39 persona është vendosur caktimi i masës së sigurimit personal me karakter shtërngues “Arresti në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, për 1 person është vendosur caktimi i masës së sigurimit personal me karakter shtërngues “Shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik”, parashikuar nga neni 239 i Kodit të Procedurës Penale, si dhe për 54 persona është caktuar masa e sigurimit personal me karakter shtërngues “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale.

3.5.3 Sipas tabelës paraqiten si më poshtë:

Lloji i masës	238	238 mungesë	238 me afat	237	234	239	Totali
Prokurori	70	8	1	31	53	1	165
Gjykata	61	8	1	39	54	1	165

Neni 324/a Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim	1									
Totali	15	2	12	7	9	14	8	55		5

VEPRAT PENALE PËR	2022	2023
--------------------------	-------------	-------------

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

ZGJEDHJET E LIRA	2022					2023				
	Numri i procedimeve të regjistruara	Numri i procedimeve për gjykim	Numri i të pandehurve të regjistruar	Numri i të pandehurve për gjykim	Numri i të pandehurve të dënuar	Numri i procedimeve të regjistruara	Numri i procedimeve për gjykim	Numri i të pandehurve të regjistruar	Numri i të pandehurve për gjykim	Numri i të pandehurve të dënuar
Neni 325 Pengimi i subjekteve zgjedhore										
Neni 326 Falsifikimi i dokumenteve dhe rezultateve të zgjedhjeve										
Neni 327 Shkelja e fshehtësisë së votimit	1									
Neni 327/a Votimi më shumë se një herë ose pa u identifikuar						1				
Neni 328/a Detyrimi për pjesëmarrje në veprimtari politike										
Neni 329 Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje	1		1			2				
Neni 330 Pengimi i zgjedhësit										
Neni 330/a Braktisja e detyrës nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve										
Neni 331 Shkelja e të drejtës së zgjedhjes										
Neni 332 Shpërdorimi i autoritetit ushtarak										
Totali	2		1			3				

VEPRA PENALE KUNDËR KORRUPSIONIT	2022					2023				
	Numri i procedimeve të regjistruara	Numri i procedimeve për gjykim	Numri i të pandehurve të regjistruar	Numri i të pandehurve për gjykim	Numri i të pandehurve të dënuar	Numri i procedimeve të regjistruara	Numri i procedimeve për gjykim	Numri i të pandehurve të regjistruar	Numri i të pandehurve për gjykim	Numri i të pandehurve të dënuar
Neni 124/a Kërkimi ose marrja e shpërblimeve për procedurat e birësimit										
Neni 164/a Korrupsion aktiv në sektorin privat										
Neni 164/b Korrupsion pasiv në sektorin privat						1				
Neni 244 Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	1					1		1	1	1
Neni 244/a Korrupsioni aktiv i nëpunësve të huaj publikë										
Neni 245 Korrupsion aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë										
Neni 245/1 Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike										

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

Neni 259 Korrupsion pasiv i personave me funksione publike						1		3		
Neni 259/a Korrupsioni pasiv i nëpunësve të huaj publikë										
Neni 260 Korrupsion pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë										
Neni 312 Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, ekspertit ose përkthyesit										
Neni 319 Korrupsion aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë										
Neni 319/a Korrupsioni aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare										
Neni 319/b Korrupsioni aktiv i arbitrit vendas dhe të huaj										
Neni 319/c Korrupsioni aktiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja										
Neni 319/ç Korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë										
Neni 319/d Korrupsioni pasiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare										
Neni 319/dh Korrupsioni pasiv i arbitrit vendas dhe të huaj										
Neni 319/e Korrupsioni pasiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja										
Neni 328 Dhenia e shperblimeve dhe e premtimeve										
Totali	1					3		4	1	1

TRAFIKIMI	2022					2023				
	Numri i procedimeve të regjistruara	Numri i procedimeve për gjykim	Numri i të pandehurve të regjistruar	Numri i të pandehurve për gjykim	Numri i të pandehurve të dënuar	Numri i procedimeve të regjistruara	Numri i procedimeve për gjykim	Numri i të pandehurve të regjistruar	Numri i të pandehurve për gjykim	Numri i të pandehurve të dënuar
Neni 110/a Trafikim i Personave	1									
Neni 128/b Trafikimi i të miturve										
Neni 138/a Trafikimi i veprave të artit dhe kulturës										

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

Neni 141/a Trafikimi i mjeteve motorike	2					4				
Neni 278/a Trafikimi i armëve dhe i municionit										
Neni 282/a Trafikimi i lëndëve plasëse, djegëse, helmuese dhe radioaktive										
Neni 283/a Trafikimi i narkotikëve						1	1			
Totali	3					5	1			
Kodi Penal Ushtarak	1	1	1	1	1	0				

KRIMI KIBERNETIK	2022					2023				
	Numri i procedimeve të regjistruara	Numri i procedimeve për gjykim	Numri i të pandehurve të regjistruar	Numri i të pandehurve për gjykim	Numri i të pandehurve të dënuar	Numri i procedimeve të regjistruara	Numri i procedimeve për gjykim	Numri i të pandehurve të regjistruar	Numri i të pandehurve për gjykim	Numri i të pandehurve të dënuar
Neni 74/a Shpërndarja kompjuterike e materialeve komp. pro genocitit ose krimeve kunder njerëzimit										
Neni 84/a Kanosja me motive racizmi dhe ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik										
Neni 119/a Shpërndarja e materialeve raciste ose ksenofobie nëpërmjet sistemit kompjuterik										
Neni 119/b Fyerja me motive racizmi ose ksenofobie nëpërmjet sist. komp.										
Neni 143/b Mashtrimi kompjuterik	1									
Neni 186/a Falsifikimi kompjuterik	1					2				
Neni 192/b Hyrja e paautorizuar kompjuterik										
Neni 293/a Përgjimi i paligjshëm i të dhënave kompjuterik										
Neni 293/b Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike	1									
Neni 293/c Ndërhyrja në sistemet kompjuterike										
Neni 293/ç Keqpërdorimi i pajisjeve										
Totali	3					2				

Këtu janë hedhur dhe të dhënat e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat për vitin 2022 dhe 4-mujorin e vitit 2023.

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

V. ANALIZA E TREGUESVE TË EFEKTIVITETIT TË PUNËS SË PROKURORISË.

5.1 Treguesi i efektivitetit në hetimin dhe ndjekjen penale, raporti i çështjeve dhe të pandehurve të dërguara me kërkesë për gjykim me ato të pushuara dhe raporti i çështjeve të pezulluara me çështjet e përfunduara në hetimet paraprake. Gjatë periudhës së vitit 2023, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës të Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër janë ndjekur gjithsej **1793** procedime penale, nga të cilat për 296 procedime penale i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër me kërkesë me objekt “*Dërgimin e çështjes në gjyq*”, me 334 të pandehur, për 376 procedime penale ka konkluduar me vendim me objekt “*Pushimin e çështjes*” ose i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër me kërkesë me objekt “*Pushimin e çështjes*”, me 128 persona në hetim, 133 procedime penale janë pezulluar, si dhe janë përfunduar 811 çështje penale.

5.2 Treguesi i efektivitetit në gjykimin dhe në dënimin e të pandehurve.

5.2.1 Gjatë vitit 2023, pas dërgimit të procedimeve penale para Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër (përfshirë këtu edhe dosjet e mbartura në gjykim nga viti 2022), gjithsej 296 çështje, me 334 të pandehur dhe ka përfunduar gjykimi për 249 procedime penale, me 287 të pandehur. Janë mbartur në gjykim për në vitin 2023 gjithsej 47 çështje, me 47 të pandehur.

5.2.2 Në vitin 2022 janë dërguar për gjykim 235 procedime penale, me 312 të pandehur, para Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër (përfshirë këtu edhe dosjet e mbartura në gjykim nga viti 2021), gjithsej 95 çështje, me 119 të pandehur dhe ka përfunduar gjykimi për 330 procedime penale, me 341 të pandehur.

5.3 Të dhëna për gjykimet e posaçme (numri i procedimeve për të cilat është proceduar me secilin nga llojet e gjykimeve të posaçme, numrin e të pandehurve lidhur me to, vendimmarrja e gjykatës). Në vitin 2023, numri i procedimeve për të cilat është proceduar me gjykime të posaçme është 199 çështje, me 227 të pandehur, nga të cilat për 19 procedime penale është proceduar me gjykim të drejtpërdrejtë dhe për 180 procedime penale është proceduar me gjykim të shkurtuar.

VITI	Gjykimi i drejtpërdrejtë	Të pandehur	Gjykimi i shkurtuar	Të pandehur	Gjykimi me marrëveshje	Totali i çështjeve	Totali të pandehurve
2022	7	7	266	313	-----	273	320
2023	19	19	180	208	-----	199	227

5.4 Të dhëna mbi llojet dhe masat e dënimeve (kërkesat e prokurorit dhe disponimet e gjykatës).

5.4.1 Siç u relatua më sipër, për vitin 2023, sipas të dhënave statistikore, ka përfunduar gjykimi në gjykatë për 249 çështje, me 287 të pandehur. Në varësi të llojit të veprave penale, sanksioneve përkatëse, rrezikshmërisë së tyre dhe të të pandehurve, shkallës së fajit dhe rrethanave lehtësuese e rënduese, janë bërë edhe kërkimet e prokurorit për llojin dhe masën e dënimit.

5.4.2 Nga Prokurori është kërkuar dënim me burgim për 55 të pandehur, nga të cilët vetëm për 21 të pandehur është kërkuar dënimi me minimumin e parashikuar nga ligji, për 34 të

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

pandehur në kufijtë mesatarë të dënimit, për 30 të pandehur është kërkuar dënim me gjobë, ndërsa për 169 të pandehur është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim (*sipas nenit 59 të Kodit Penal*).

5.4.3 Nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër është vendosur dënimi me burgim për 287 të pandehur (*nga 287 të kërkuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër*), nga të cilët 20 të pandehur në kufijtë e minimumit të dënimit, 31 të pandehur në kufijtë e dënimit mesatar, ndërsa për 175 të pandehur Gjykata ka aplikuar pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim (*sipas nenit 59 të Kodit Penal*), kurse dënimi me gjobë është dhënë për 31 të pandehur (*nga 67 të kërkuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër*).

5.4.4 Për vitin 2023, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka deklaruar të pafajshëm 2 të pandehur, ka vendosur pushimin e çështjes për 2 të pandehur, ka vendosur pushimin e çështjes, sipas kërkesës së prokurorit për nenet 90 dhe 125 të Kodit Penal, në 4 raste dhe në 3 çështje, për 6 të pandehur, ka vendosur shpalljen e moskompetencës, si dhe në 1 çështje është vendosur kthimi i akteve.

5.4.5 Krahasuar me vitin 2022, konstatohet një rritje e numrit të çështjeve të gjykuara, më konkretisht për vitin 2023, krahasuar me një vit më parë, ku janë gjykuar 236 çështje, me 282 të pandehur, kundrejt 249 çështjeve, me 287 të pandehur, të përfunduara gjatë vitit 2023.

5.5 Të dhëna sociale dhe demografike, ashtu dhe për viktimat e veprave penale, si gjinia, moshë, arsimit, punësimi etj. Nga të dhënat statistikore rezulton se numri i të pandehurve është 513, nga të cilët 26 prej tyre janë të mitur meshkuj në moshën 14-18-vjeç, si dhe 10 femra mbi 18 vjeç, të huaj 7, me arsim 9-vjeçar 425, me arsim të mesëm 72, me arsim të lartë 15, me status: nëpunës i lartë 1, nëpunës i mesëm 4, nëpunës i ulët 3, banues në qytet 169, banues në komunë 344, dënuar për të njëtin vepër penale 44, dënuar për vepra të ndryshme penale 33, të padënuar 402. Viktima të veprës penale janë 82, nga të cilat 44 femra dhe 38 meshkuj. Nga këto, 9 janë të mitur të moshës 14-18 vjeç (4 meshkuj dhe 5 femra).

5.6 Të dhëna për të pandehurit e mitur si: numrin e procedimeve të regjistruara, numrin e procedimeve të dërguara për gjykim, numrin e të pandehurve dhe personave nën hetim të mitur të regjistruar, numrin e të pandehurve të mitur dërguar për gjykim, numrin e të pandehurve dënuar; numër procedimesh regjistruar, masa sigurimi e dënime të zbatuara, dënime alternative, etj.

5.6.1 Gjatë vitit 2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka regjistruar 31 procedime penale me 32 të pandehur/persona nën hetim, 32 nga të cilët të mitur (meshkuj), 9 të grup moshës 14-16 vjeç dhe 23 të grup moshës 16-18 vjeç.

5.6.2 Në përfundim rezulton se për 31 procedime penale, me 27 të mitur në konflikt me ligjin, është vendosur "*Pushimi i çështjes*", në bazë të neneve 55, 56, 58 dhe 67 të ligjit nr.37, të vitit 2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit", si dhe nenit 328, gërma "f" të Kodit të Procedurës Penale, për shkak se ndaj të miturit në konflikt me ligjin është zbatuar "*Masa e shmangies nga ndjekja penale*".

5.7 Të dhëna për pasojat e veprave penale. Si rezultat i veprave penale evidentohen 59 viktima me pasoja **dëm shëndeti**, konkretisht 11 të vdekur, 21 të plagosur rëndë dhe 27 të plagosur lehtë.

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

VI. TË DHËNA LIDHUR ME MARRËDHËNIET JURIDIKSIONALE ME AUTORITETET E HUAJA.

6.1 Ekstradime (ekstradime nga jashtë, ekstradime për jashtë).

6.1.1 Ekstradime për jashtë shtetit: 6 praktika

6.1.2 Ekstradime nga jashtë shtetit: 3 praktika

6.2 Letërporositë (letërporositë nga jashtë, komisione rogatore dhe dorëzime të kontrolluara, letërporositë për jashtë).

6.2.1 Letërporosi për jashtë shtetit: 3 praktika

6.2.2 Letërporosi nga jashtë shtetit: 20 praktika

6.2.3 Komisione rogatore: 0

6.2.4 Dorëzime të kontrolluara: 0

6.3 Njohjet e vendimeve penale (njohjet e vendimeve penale të huaja, njohjet e vendimeve penale shqiptare jashtë vendit).

6.3.1 Njohjet e vendimeve penale të huaja: 2 praktika

6.3.2 Njohjet e vendimeve penale shqiptare jashtë vendit: 0

6.4 Transferime të procedimeve penale (transferimet e procedimeve nga jashtë, transferimet e procedimeve për jashtë). Për vitin 2023, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër nuk ka patur transferime të procedimeve penale (transferime të procedimeve nga jashtë apo transferime të procedimeve për jashtë).

6.5 Transferime të personave të dënuar (transferime të personave të dënuar nga jashtë, transferime të personave të dënuar për jashtë). Gjatë vitit 2023, janë transferuar 3 persona të dënuar nga jashtë dhe 2 persona të dënuar janë transferuar për jashtë.

6.6 Shpallje në kërkim ndërkombëtar, heqjet nga kërkimi ndërkombëtar. Gjatë vitit 2023 janë përpiluar praktikat për shpalljen e 3 personave në kërkim ndërkombëtar (shtetas shqiptarë, të cilët kanë kryer krime në territorin e Republikës së Shqipërisë).

VII. TË DHËNA PËR NGARKESËN DHE TREGUESIT E PUNËS PËR PROKURORËT, SHEFAT E SEKTORIT, ZËVENDËSPROKURORI DHE DREJTUESI I PROKURORISË.

7. Në Prokurorinë pranë Gjykatës Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, sipas urdhërit nr.54, datë 18.04.2023, dërguar me shkresën nr.600/4 prot., datë 24.04.2023, të Prokurorisë së Përgjithshme, me të cilën është miratuar struktura organike e Prokurorisë pranë Gjykatës Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, duke përfshirë edhe organikën e ish-Prokurorisë pranë Gjykatës Shkallës së Parë Mat është si vijon:

7.1 Numri i prokurorëve dhe administrata gjatë vitit 2023.

7.1.1 Në vitin 2023, në Prokurorinë pranë Gjykatës Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, së bashku me ish-Prokurorinë pranë Gjykatës Shkallës së Parë Mat, numri i përgjithshëm i miratuar është **8 prokurorë**. Nga ky numër i përgjithshëm i miratuar i prokurorëve, ka patur dinamikë në këtë numër, pasi ky numër nuk ka qenë i plotë gjatë gjithë periudhës të vitit 2023.

7.1.2 Nga 8 prokurorë të miratuar, dinamika paraqitet si më poshtë:

7.1.2.1 4 (katër) prokurorë me kohë të plotë, efektiviteti 10 – 12 muaj = 4 prokurorë.

7.1.2.2 1 (një) prokuror i ka mbaruar statusi i magjistratit më datë 31.07.2023, efektiviteti 7 – 9 muaj = 0.75 %.

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

7.1.2.3 1 (një) prokuror është transferuar më datë 30.09.2023, efektiviteti 7 – 9 muaj = 0.75 %.

7.1.2.4 1 (një) prokuror ka marrë raport mjekësor lindje më datë 06.09.2023, efektiviteti 7 – 9 muaj = 0.75 %.

7.1.2.5 1 (një) prokuror është emëruar më datë 10.07.2023, efektiviteti 4 – 6 muaj = 0.5 %.

7.1.2.6 Në këto rrethana, me kohë të plotë kanë ushtruar veprimtarinë e tyre në detyrën e prokurorit 4 prokurorë.

7.2 Drejtuesi aktual i Prokurorisë **Abaz Muça** (periudha nga data 01.01.2023 deri më datë 31.12.2023) ka trajtuar në total një numër prej **253** materialesh, duke mbartur për në vitin 2024 gjithsej **23** procedime penale dhe **5** referime pasurore, me shpërndarje si më poshtë:

7.2.1 Ka hetuar gjithsej 183 procedime penale, nga të cilat: 45 çështje janë dërguar për gjykim (kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, kërkesë për miratim marrëveshje apo urdhër penal), 7 çështje janë pezulluar, 49 çështje janë pushuar ose është kërkuar pushimi në gjykatë, 75 çështje janë rifilluar të pezulluara, 1 çështje është rifilluar e pushuar, 2 çështje janë dërguar për kompetencë dhe 4 çështje janë mbartur për në vitin 2023.

7.2.2 Ka trajtuar 70 materiale kallëzuese, nga të cilat janë mosfilluar po 70 materiale kallëzuese.

7.2.3 Ka mbartur për në vitin 2024 gjithsej 23 procedime penale.

7.2.4 Ka në ndjekje 3 referime pasurore.

7.2.5 Në përmbushje të detyrës së Zëvendësdrejtuesit të Prokurorisë, nga data 05.05.2023 deri më datë 31.12.2023, ka ushtruar kompetencat, përgjegjësitë dhe detyrat që parashikohen nga legjislacioni përkatës.

7.2.6 Për sa sipër, për periudhën raportuese veç sa sipër, ka mbuluar edhe detyrën e prokurorit të ekzekutimeve të vendimeve penale gjyqësore, si dhe ka përfaqësuar organin e akuzës në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër në gjykimin e kërkesave të të dënuarve pranë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Burrel, si kërkesa për lirim me kusht sipas neneve 64 dhe 59 të Kodit Penal etj.

7.3 Prokurori **Urim Buci** (periudha nga data 01.01.2023 deri më datë 31.12.2023) ka trajtuar në total një numër prej **313** materialesh, duke mbartur për në vitin 2024 gjithsej **167** procedime penale dhe **18** referime pasurore, me shpërndarje si më poshtë:

7.3.1 Ka hetuar gjithsej 253 procedime penale, nga të cilat: 67 çështje janë dërguar për gjykim (kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, kërkesë për miratim marrëveshje apo urdhër penal), 21 çështje janë pezulluar, 63 çështje janë pushuar ose është kërkuar pushimi në gjykatë, 45 çështje janë rifilluar të pezulluara dhe 57 çështje janë mbartur për në vitin 2023.

7.3.2 Ka trajtuar 60 materiale kallëzuese, nga të cilat 15 materiale kallëzuese janë mosfilluar dhe 45 materiale kallëzuese mbartur për në vitin 2023.

7.3.3 Ka mbartur për në vitin 2024 gjithsej 167 procedime penale.

7.3.4 Ka në ndjekje 18 referime pasurore.

7.4 Prokurori **Rifat Kojku** (periudha nga data 01.01.2023 deri më datë 30.07.2023²) ka trajtuar në total një numër prej **77** materialesh, me shpërndarje si më poshtë:

² Me vendimin nr.282, datë 10.07.2023, Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) ka vendosur:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të zotit Rifat Kojku, aktualisht prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.
2. Mbarimi i statusit të magjistratit për zotën Rifat Kojku i jep efektet nga data 31.07.2023.

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

7.4.1 Ka hetuar gjithsej 66 procedime penale, nga të cilat: 16 çështje janë dërguar për gjykim (kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, kërkesë për miratim marrëveshje apo urdhër penal), 9 çështje janë pezulluar, 18 çështje janë pushuar ose është kërkuar pushimi në gjykatë dhe 22 çështje janë rifilluar të pezulluara.

7.4.2 Ka trajtuar 11 materiale kallëzuese, nga të cilat janë mosfilluar po 11 materiale kallëzuese.

7.4.3 Në përmbushje të detyrës së Drejtuesit të Prokurorisë, nga data 01.01.2023 deri më datë 24.04.2023, ka ushtruar kompetencat, përgjegjësitë dhe detyrat që parashikohen nga legjislacioni përkatës.

7.5 Prokurorja **Xhoana Mehmetaj** (periudha nga 01.01.2023-06.09.2023³) ka trajtuar në total një numër prej **219** materialesh me shpërndarje si më poshtë:

7.5.1 Ka hetuar gjithsej 174 procedime penale, nga të cilat: 31 çështje janë dërguar për gjykim (kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, kërkesë për miratim marrëveshje apo urdhër penal), 18 çështje janë pezulluar, 79 çështje janë pushuar ose është kërkuar pushimi në gjykatë, 45 çështje janë rifilluar të pezulluara dhe 1 çështje është transferuar.

7.5.2 Ka trajtuar 45 materiale kallëzuese, nga të cilat: 35 materiale kallëzuese janë mosfilluar dhe 10 materiale kallëzuese janë mbartur për në vitin 2022.

7.5.3 Ka ndjekur 10 hetime pasurore.

7.6 Prokurorja **Alisa Spahja** (periudha nga data 01.01.2023 deri më datë 31.12.2023) ka trajtuar në total një numër prej **349** materialesh, duke mbartur për në vitin 2024 gjithsej **139** procedime penale dhe **5** referime pasurore, me shpërndarje si më poshtë:

7.6.1 Ka hetuar gjithsej 217 procedime penale, nga të cilat: 50 çështje janë dërguar për gjykim (kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, kërkesë për miratim marrëveshje apo urdhër penal), 35 çështje janë pezulluar, 74 çështje janë pushuar ose është kërkuar pushimi në gjykatë, 56 çështje janë rifilluar të pezulluara dhe 2 çështje janë dërguar për kompetencë.

7.6.2 Ka trajtuar 132 materiale kallëzuese, nga të cilat: 78 materiale kallëzuese janë mosfilluar dhe 54 materiale kallëzuese janë mosfilluar, të mbartuara nga viti 2023.

7.6.3 Ka mbartur për në vitin 2024 gjithsej 139 procedime penale.

7.6.4 Ka në ndjekje 5 referime pasurore.

7.7 Prokurori **Urim Kalia** (periudha nga data 01.01.2023 deri më datë 31.12.2023) ka trajtuar në total një numër prej **363** materialesh, duke mbartur për në vitin 2024 gjithsej **91** procedime penale dhe **2** referime pasurore, me shpërndarje si më poshtë:

7.7.1 Ka hetuar gjithsej 222 procedime penale, nga të cilat: 59 çështje janë dërguar për gjykim (kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, kërkesë për miratim marrëveshje apo urdhër penal), 36 çështje janë pezulluar, 65 çështje janë pushuar ose është kërkuar pushimi në gjykatë, 60 çështje janë rifilluar të pezulluara, 1 çështje është rifilluar e pushuar dhe 1 çështje është dërguar për kompetencë.

7.7.2 Ka trajtuar 141 materiale kallëzuese, nga të cilat: 85 materiale kallëzuese janë mosfilluar dhe 56 materiale kallëzuese mbartur në vitin 2023.

7.7.3 Ka mbartur për në vitin 2024 gjithsej 91 procedime penale.

7.7.4 Ka në ndjekje 2 referime pasurore.

³ Më datë 07.09.2023, prokurorja Xhoana Mehmetaj është pajisur me raport mjekësor për leje barrë lindje nr.1831 regjistri, lëshuar nga institucioni shëndetsor Qendra Shëndetësore Nr.2 Tiranë, për paaftësi për punë.

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

7.8 Prokurorja **Alma Bramo** (periudha nga data 01.01.2023 deri më datë 30.09.2023⁴), ka trajtuar në total një numër prej **129** materialesh me shpërndarje si më poshtë:

7.8.1 Ka hetuar gjithsej 89 procedime penale, nga të cilat: 18 çështje janë dërguar për gjykim (kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, kërkesë për miratim marrëveshje apo urdhër penal), 5 çështje janë pezulluar, 16 çështje janë pushuar ose është kërkuar pushimi në gjykatë, 1 çështje është rifilluar e pezulluara dhe 1 çështje është dërguar për kompetencë.

7.8.2 Ka trajtuar 40 materiale kallëzuese, nga të cilat janë mosfilluar po 40 materiale kallëzuese.

7.9 Prokurori **Drini Zeqo** (periudha nga data 10.07.2023⁵ deri më datë 31.12.2023) ka trajtuar në total një numër prej **106** materialesh, duke mbartur për në vitin 2024 gjithsej **155** procedime penale dhe **9** referime pasurore, me shpërndarje si më poshtë:

7.9.1 Ka hetuar gjithsej 72 procedime penale, nga të cilat: 10 çështje janë dërguar për gjykim (kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, kërkesë për miratim marrëveshje apo urdhër penal), 2 çështje janë pezulluar, 12 çështje janë pushuar ose është kërkuar pushimi në gjykatë dhe 48 çështje janë rifilluar të pezulluara.

7.9.2 Ka trajtuar 34 materiale kallëzuese, nga të cilat janë mosfilluar po 34 materiale kallëzuese.

7.9.3 Ka mbartur për në vitin 2024 gjithsej 155 procedime penale.

7.9.4 Ka në ndjekje 9 referime pasurore.

7.10 Në lidhje me procedimet penale dhe referimet pasurore të mbartura për në vitin 2024 i ndajmë si më poshtë:

PROCEDIME PENALE & REFERIME PASURORE TË MBARTURA PËR NË VITIN 2024	
	Mbartur
Gjithsej	614
Procedime penale	575
Referime pasurore	39
SIPAS PROKURORËVE	
Abaz Muça	23 Procedime penale + 5 Referime pasurore
Urim Buci	167 Procedime penale + 18 Referime pasurore
Alisa Spahja	139 Procedime penale + 5 Referime pasurore
Urim Kalia	91 Procedime penale + 2 Referime pasurore
Drini Zeqo	155 Procedime penale + 9 Referime pasurore

⁴ Me vendimin nr.237, datë 03.07.2023, Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) ka vendosur:

1. Caktimin e zonjës Alma Bramo në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në pozicionin vakant nr.4, shpallur me vendimin nr.92, datë 09.05.2023 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
2. Marrëdhëniet financiare që lidhen me pagën dhe përfitimet e tjera do të përballohen nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës duke filluar nga data 05.07.2023.
3. Zonja Alma Bramo do të vijojë ushtrimin e detyrës në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibrë deri në datë 30.09.2023.

⁵ Me vendimin nr.276, datë 10.07.2023, Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) ka vendosur:

1. Të caktojë zotin Drini Zeqo, në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibrë.

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

SIPAS VITEVE	
2013	1
2014	1
2015	0
2016	3
2017	14
2018	18
2019	32
2020	86
2021	128
2022	110
2023	221
TOTALI	614

Në lidhje me procedimet penale dhe referimet pasurore të mbartura ndër vite për në vitin 2024 theksojmë se mbartja e tyre ka qenë si rezultat i transferimit/largimit/shkarkimit të prokurorëve, por për një pjesë të tyre, mbartja e tyre ndër vite është e pajustificueshme, si dhe mund të sjellë pasoja, siç është parashkrimi i ndjekjes penale.

7.11 Oficeri i Policisë Gjyqësore **Aldo Puca** ka hetuar **152** procedime penale dhe për **85** prej tyre ka përfunduar hetimet. Ka sugjeruar dërgimin e çështjes në gjyq për 70 procedime penale, për pushim 4 procedime penale, për pezullim 1 procedim penal dhe për kompetencë 1 procedim penal. Ndërkohë, janë mbartur për hetim **69** procedime penale. Gjithashtu, nga ana e oficerit janë kryer 82 veprime hetimore të deleguara posaçërisht nga prokurorët.

7.12 Oficerja e Policisë Gjyqësore **Erisa Skara** ka hetuar **146** procedime penale dhe për **102** prej tyre ka përfunduar hetimet. Ka sugjeruar dërgimin e çështjes në gjyq për 38 procedime penale, për pushim 60 procedime penale dhe për pezullim 4 procedime penale. Ndërkohë, janë mbartur për hetim **52** procedime penale. Gjithashtu, nga ana e oficerit janë trajtuar 3 materiale kallëzuese dhe janë kryer 15 veprime hetimore të deleguara posaçërisht nga prokurorët.

7.13 Oficeri i Policisë Gjyqësore **Artan Ballabani** ka hetuar **134** procedime penale dhe për **82** prej tyre ka përfunduar hetimet. Ka sugjeruar dërgimin e çështjes në gjyq për 27 procedime penale, për pushim 48 procedime penale, për pezullim 5 procedime penale dhe për kompetencë 2 procedime penale. Ndërkohë, janë mbartur për hetim **52** procedime penale. Gjithashtu, nga ana e oficerit janë kryer 45 veprime hetimore të deleguara posaçërisht nga prokurorët.

7.14 Oficeri i Policisë Gjyqësore **Amarildo Margjoni** ka hetuar **71** procedime penale dhe për **25** prej tyre ka përfunduar hetimet. Ka sugjeruar dërgimin e çështjes në gjyq për 11 procedime penale, për pushim 8 procedime penale, për pezullim 6 procedime penale dhe për kompetencë 1 procedim penal. Ndërkohë, janë mbartur për hetim **46** procedime penale. Gjithashtu, nga ana e oficerit janë kryer 36 veprime hetimore të deleguara posaçërisht nga prokurorët.

7.15 Oficeri i Policisë Gjyqësore **Ilir Haxhiaj** ka hetuar **76** procedime penale dhe për **66** prej tyre ka përfunduar hetimet. Ka sugjeruar dërgimin e çështjes në gjyq për 28 procedime penale,

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

për pushim 31 procedime penale dhe për pezullim 7 procedime penale. Ndërkohë, janë mbartur për hetim 10 procedime penale.

7.16 Oficeri i Policisë Gjyqësore **Azi Mustafallari** ka hetuar **70** procedime penale dhe për **24** prej tyre ka përfunduar hetimet. Ka sugjeruar dërgimin e çështjes në gjyq për 11 procedime penale, për pushim 9 procedime penale dhe për pezullim 4 procedime penale. Ndërkohë, janë mbartur për hetim **46** procedime penale. Gjithashtu, nga ana e oficerit janë kryer 42 veprime hetimore të deleguara posaçërisht nga prokurorët.

VIII. INFORMACION MBI ADMINISTRIMIN DHE VEPRIMTARINË ADMINISTRATIVE TË PROKURORISË.

8. Për vitin 2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër ka në strukturën e saj 8 prokurorë, 7 oficerë të policisë gjyqësore, 1 kryesekretar, 2 sekretarë, 1 koordinator, 1 shofer, 1 kryetar dege buxhet finance, 2 specialist-arkivist, 1 teknik të mesëm të specialiteteve të ndryshme, 1 punonjës shërbimi dhe 1 sanitare (me kohë të pjesshme).

8.1 Kjo strukturë organike nuk ka qenë e mjaftueshme për ngarkesën e punës në këtë prokurori. Kjo ka të bëjë me numrin e ulët të sekretarëve. Veprimtaria administrative dhe procedurale në sekretari në prokurori ka qenë dinamike dhe e ngarkuar. Materialet e procedimeve penale të kategorive të ndryshme shumëfishohen në kopje, ato inventarizohen dhe qepen. Problem mbetet hedhja e të dhënave në regjistra dhe tabela dhe sistemin CAMS, përpilimi dhe përpunimi i të dhënave statistikore peroidike. Të gjitha këto duan një person (post pune) për t'i mbledhur, për t'i përpunuar, për t'i hedhur dhe për t'i administruar në formën e kërkuar dhe të duhur. E gjithë kjo veprimtari nuk mund të kryhet nga persona të tjerë, pasi posti i punës duhet të jetë i përcaktuar vetëm për statistikat.

8.2 Në mbarëvajtjen e punës të veprimtarisë së prokurorisë, një rol të rëndësishëm kryen dhe administrata e prokurorisë. Rezulton tashmë një evidencë e saktë dhe e qartë që nga momenti i protokollimit të materialeve në kryesekretari e më pas në regjistrat e materialeve kallëzuese, procedimeve penale, mosfillimeve, marrëdhënieve juridiksionale me jashtë etj., mbajtur nga kryesekretaria.

8.3 Të gjitha materialet kallëzuese janë regjistruar në sistemin CAMS, duke operuar me kujdes në këtë sistem, për të pasqyruar saktë të dhënat përkatëse në bashkëpunim dhe me strukturën përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme.

8.4 Nga kryesekretaria janë evidentuar me korrektësi shpenzimet procedurale të çështjeve penale të parapaguara nga shteti e të mbajtura nga prokurorët. Gjatë vitit 2023, nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër janë marrë të gjitha masat për zbatimin e udhëzimit të përgjithshëm nr.8, të vitit 2020 "Për shpenzimet procedurale penale në prokurorit juridiksion të përgjithshëm", të ndryshuar me udhëzimin nr.6, të vitit 2021, për implementimin dhe zbatimin e këtyre udhëzimeve, me qëllim garantimin e ndihmës juridike falas të garantuar nga shteti sipas legjislacionit në fuqi vetëm personave, të cilët e përfitojnë atë, për caktimin e masës së shpenzimeve të pagesave të ekspertëve, në caktimin e ekspertëve të fushës sipas përcaktimeve ligjore etj.


8.5 Nga ana e Prokurorëve, pas përfundimit të hetimit të çështjes përpilohet procesverbali mbi shpenzimet paraprake të parapaguara nga shteti, duke nxjerrë vlerën e tyre, procesverbal

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

një kopje e të cilit dorëzohet nga ana e sekretarisë në zyrën e financës së bashku me dokumentacionin ligjor për pagesë dhe kjo e fundit ka mbajtur regjistrin mbi shpenzimet procedurale në formë manuale dhe elektronike sipas kërkesave të udhëzimit nr.6, të vitit 2021, neni 3, pika 2, ku ky regjistër me këto të dhëna është raportuar në Drejtorinë Ekonomike dhe të Financës në Prokurorinë e Përgjithshme për vitin 2023.

8.6 Duke u bazuar në analizën e fondeve buxhetore në fillim të vitit 2023, shtesave gjatë vitit, për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër janë akorduar fondet në artikullin 600, 601, 602, 606 dhe 231, si më poshtë:

Artikull Buxhetor	Fonde të akorduara 2023	Shpenzime të realizuara	Diferenca
600 (Paga)	66,224,418	66,207,847	16,571
601 (Sigurime)	6,078,980	5,918,291	160,689
602 (Shpenzime Operative)	10,218,300	10,211,758	6,542
606 (Shpërblime të ndryshme)	483,255	483,255	0
231 (Investime)	400,000	382,800	17,200
Total Buxhet	83,404,953	83,203,951	201,002



8.7 Nga të dhënat e tabelës së mësipërme theksojmë se:

8.7.1 Artikulli 600 përfshin pagat, sigurimet shoqërore të punëmarrësit, tatimin mbi të ardhurat personale dhe sigurimet suplementare të punonjësve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, si dhe shpenzimet për diferencat e pagave sipas urdhërit nr.87, datë 04.07.2023 “Për përlllogaritjen e pagës referuese bazë të Magjistratit/Prokuror”, në shumën **66,207,847** lekë .

8.7.2 Artikulli 601 përfshin sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të punëdhënësit për pagat gjatë vitit ushtrimor dhe për diferencat e pagave sipas urdhërit nr.87, datë 04.07.2023 “Për përlllogaritjen e pagës referuese bazë të Magjistratit/Prokuror”, në shumën **5,918,291** lekë.


8.7.2.1 Paga dhe sigurime të paguara në total janë në shumën **72,126,138** lekë. Diferenca e mosrealizimit të plotë të fondit të akorduar vjen si pasojë e mosdeklarimit nga ana e Drejtorisë

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

Rajonale Tatimore Dibër të sigurimeve dhe tatimit për diferencat e pagave të Magjistratit/Prokuror dhe Oficerit të Policisë Gjyqësore.

8.7.3 Artikulli 602 përfshin të gjitha shpenzimet operative të domosdoshme për funksionimin e veprimtarisë së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Nga fondet e akorduara janë realizuar shpenzimet sipas zërave të mëposhtëm:

TABELË PËRMBLEDHËSE		
Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër		
Nr	Emërtimi i shpenzimit	Shuma
1	Kancelari	117900
2	Blerje dokumentacioni	118800
3	Elektricitet	342142
4	Ujë	17568
5	Shërbime telefonike	24645
6	Posta dhe shërbim korrieri	321965
7	Shërbime të sigurimit dhe ruajtjes	7269782
8	Shërbime elektrike, hidraulike	56760
9	Shërbime mirëmbajtje kondicioner	48000
10	Riparime fotokopje	115000
11	Shpenzime transporti	470755
12	Dieta	286500
13	Shpenzime honorare ASHK (Kadastra)	78800
14	Shpenzime honorare ekspert	763400
15	Shpenzime për tatim dhe taksa të paguara nga institucioni	179741
Total		10211758




RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

8.7.3.1 Nga të dhënat e mësipërme rezulton që pjesën më të madhe të shpenzimeve operative e zë “Shërbime të sigurimit dhe ruajtjes”.

8.7.3.2 Në lidhje me shpenzimet honorare për ekspertë i ndajmë si më poshtë:

Shuma e paguar	Profesioni	%
84,000	Ekonomist	11
25,000	Ekspert Kontabël	3
29,000	Psikolog	4
305,000	Avokat	40
214,400	Ekspert Ndërtimi dhe Topograf	28
66,000	Ekspert Autoteknik	9
40,000	Ekspert Kimist	5
763,400	Total ekspertë	100.0



8.7.4 Artikulli 606 përfshin shpërblimet e dhëna në rastet e daljes në pension dhe ndihmë ekonomike si rezultat i shkurtimit të vendit të punës në shumën **483,255** lekë.

8.7.5 Artikulli 231 përfshin blerje rafte arkivi në shumën **382800** lekë.

IX. INFORMACION PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE MEDIAT.

9. Në zbatim të ligjit nr.119, të vitit 2014 “Për të Drejtën e Informimit”, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë është caktuar koordinatori për të drejtën e informimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dhe gjatë vitit 2023 është hartuar dhe plotësuar regjistri i transparencës, ku janë shqyrtuar të gjitha kërkesat e

RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023

ardhura nga media të ndryshme dhe shtetas, të cilave u është kthyer përgjigje brenda një afati kohor të shpejtë dhe të mundshëm, si dhe brenda afateve ligjore.

X. OBJEKTIVAT SIPAS DREJTIMEVE PRIORITARE NË VEPRIMTARINË ADMINISTRATIVE DHE FUNKSIONALE TË PROKURORISË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2024 DHE REKOMANDIME.

10. Referuar numrit, llojeve, shtrirjes territoriale, intensitetit dhe formave të kriminalitetit dhe masave të tjera të analizuara më sipër dhe në mënyrë më të hollësishme në raport, organi i prokurorisë është përpjekur maksimalisht të përmbushë detyrat kushtetuese e ligjore dhe ka zbatuar rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë, rekomandimet e Këshillit të Ministrave, prioritetet kyçe të shtetit shqiptar në kuadër të integritit, me fokus në luftën kundër krimit të organizuar, kundër fenomeneve kriminale tradicionale, kundër krimit ekonomik dhe kundër krimeve të tjera, duke ndihmuar dhe duke kontribuar për forcimin e rendit dhe sigurisë publike, duke siguruar një procedim të drejtë dhe duke garantuar liritë personale, të drejtat dhe interesat e ligjshëm të shtetasve dhe të subjekteve të procedimit penal.

10.1 Sa u referuan treguesit e sipërpërmendur, në analizë të tyre dhe me synim përmbushjen e funksioneve kushtetuese dhe ligjore të prokurorisë, duhet të evidentojmë dhe drejtimit kryesore të punës dhe veprimtarisë për vitin 2024 në vazhdim, duke përcaktuar dhe prioritetet kryesore.

10.2 Së pari, një ndër drejtimit kryesore të veprimtarisë së punës për vitin 2024 është rritja e efektivitetit dhe cilësisë së hetimit, ngritja e cilësisë së hetimeve, pra e cilësisë së veprimeve hetimore të procedimeve penale. Cilësia në veprime pasqyron së pari ngritjen profesionale të çdo Prokurori dhe oficeri të policisë gjyqësore, duke e pasqyruar atë në përpilimin e akteve, formulimin dhe arsyetimin ligjor të vendimeve gjatë hetimit, ato përfundimtare, si dhe përfaqësimit në Gjykatë.

10.3 Së dyti, duhet rritur ndjeshëm kontrolli në dinamikë nga ana e Prokurorëve gjatë hetimeve paraprake të çështjeve, duke mos u mjaftuar me nxjerrjen e një urdhëri për kryerje veprimesh hetimore, pritjen deri në ardhjen e akteve nga shërbimet dhe seksionet e policisë gjyqësore, duke shkaktuar vonesa në hetim, humbjen e aktualitetit të një veprimi hetimor që mund të rezultojë gjatë dinamikës, etj. Në dinamikë, gjatë kontrollit të veprimtarisë hetimore nga oficeri i policisë gjyqësore, Prokurori duhet të jetë jo vetëm një orientues i veprimeve hetimore apo të nxjerrë akte proceduriale për veprime specifike si kontrole, përgjime, etj., por duhet të jetë dhe iniciues apo nxitës për një hetim sa më dinamik, të shpejtë, të një hetimi të zgjeruar për të gjitha problematikat. Duhet të evidentojë konkretisht dhe përcjellë me informacione Drejtuesit të Prokurorisë problematika të veçanta, pengesa të ndryshme qoftë që kanë të bëjnë edhe me mënyrën e funksionimit të organizimit të punës së veprimtarisë hetimore, siç janë zvarritjet e pajustificueshme etj.

10.4 Së treti, për çështje të veçanta, për shkak të rrezikshmërisë shoqërore, apo përhapjes së një krimi, duke ju referuar tendencës së kriminalitetit, aq më tepër për çështje të rënda dhe sensitive duhet bërë vlerësimi i diferencuar, duhet kryer analiza e vlerësimit të hetimeve dhe provave të administruara, duke lënë detyra konkrete, si dhe duke kryer vetë nga Prokurorët veprime hetimore.

**RAPORT VJETOR PËR ECURINË E PUNËS NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË
SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR PËRGJATË VITIT 2023**

10.5 Marrja kontakt që nga momentet e para nga prokurori me të dyshuarin (arrestuarin/hetuarin/pandehurin) krijon një perceptim më të drejtë në lidhje me hetimet që do të kryhen më pas, shmang dhe probleme procedurale në lidhje me zgjedhjen e masës shtrënguese të marrë nga shërbimet e Policisë Gjyqësore, si dhe për krijimin e një politike të drejtë të kërkesës për masë sigurimi, bazuar dhe në personalitetin e të dyshuarit etj.

10.6 Për të përmirësuar më tej performancën në të gjithë treguesit e saj, do të fokusohemi në rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së hetimit, ngritjen e profesionalizmit të Prokurorëve dhe të oficerëve të policisë gjyqësore, fuqizimin e pavarësisë së institucionit, si dhe rritjen e bashkëpunimit me institucionet e tjera ligjzbatuese. Gjithashtu, në fokus do të jetë edhe rritja e efikasitetit në ndjekjen e hetimeve sistematike pasurore, sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale dhe forcimin e kapaciteteve profesionale në këtë drejtim.

10.7 Gjithashtu, fokus do të ketë edhe në marrjen e masave për ushtrimin e ndjekjes penale në bazë të ligjit për çdo referim/material kallëzues, i cili përmban element të figurës së veprës penale dhe do të disponohet me vendim me objekt *“Mosfillimin e procedimit penal”*, brenda afatit prej 15 ditësh, për materialet kallëzuese/referimet, për të cilat ekzistojnë shkaqe dhe rrethana që nuk lejojnë fillimin e një procedimi penal.

10.8 Në luftën kundër korrupsionit, evidentimi, vlerësimi dhe hetimi i veprave penale të referuara apo evidentuara kryesisht që lidhen me veprime korruptive, të cilat kanë të bëjnë me subjekte të administratës shtetërore apo private. Duhet nënvizuar fakti që nga ana e Prokurorëve duhet treguar vëmendje më e madhe në drejtim të vlerësimit të fakteve që rezultojnë gjatë hetimeve, për raste kur konstatohen indicie për vepra penale të karakterit korruptiv. Duhet treguar vëmendje dhe në drejtim të fakteve për të cilat ndihet një shqetësim i përgjithshëm i komunitetit.

10.9 Në luftën kriminale të organizuar në veçanti dhe ulja e nivelit të kriminalitetit në përgjithësi, kryerja e analizave të përbashkëta me seksionet dhe sektorët e shërbimeve të Policisë për veprat penale sensitive, por edhe me faktorë të tjerë, ku duhen përmendur veprat penale kundër autoritetit të shtetit dhe korrupsionit, sidomos ato vepra penale që kanë impakt negativ në komunitet si *“Kultivimi i bimëve narkotike”*, duke e minimizuar apo zëruar, duke rritur rastet e hetimeve proaktive dhe veprimeve simuluese. Gjithashtu, duhet punuar më tepër nga oficerët e policisë gjyqësore për zbulueshmërinë e veprave penale, sidomos atyre në sferën ekonomike pasi zbulueshmëria për këtë vepër penale është në nivelin minimal.

D R E J T U E S I

ABAZ MUÇA